



Bashkimi Ndërparlamentar
Për demokraci Për të gjithë



UNHCR
Agjencia e Kombeve
të Bashkuara për Refugjatët

Shtetësia dhe Pashtetësia

Doracak për Parlamentarët Nr° 22



Përmbajtja

Mirënjohjet	2
Parathënie.....	3
Hyrje	5
Kuadri ligjor ndërkombëtar për të drejtën e një shtetësie dhe për reduktimin e pashtetësisë.....	7
Identifikimi dhe mbrojtja e personave pa shtetës.....	17
Parandalimi i pashtetësisë.....	29
Roli i UNHCR-së	43
Si mund të ndihmojnë parlamentarët.....	49
Shtojca 1 Vendet anëtare të Konventës së vitit 1954 për Statusin e Personave pa Shtetësi.....	57
Shtojca 2 Vendet anëtare të Konventës së vitit 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë.....	60
Shtojca 3 Instrumenti Model i aderimit në Konventën e vitit 1954 për Statusin e Personave pa Shtetësi	62
Instrumenti Model i aderimit në Konventën e vitit 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë.....	63
Prezantim i shkurtër me BNP dhe UNHCR	64

Mirënjohje

Ky manual është përgatitur me bashkëpunimin e Komitetit të Bashkimit Ndër-Parlamentar për të Promovuar Respektin ndaj **Hulumtimit dhe Analizës** së të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare:

Edicioni i parë (2005): Carol Batchelor dhe Philippe LeClerc (UNHCR)

Edicioni i dytë (2014): Mark Manly dhe Radha Govil (UNHCR)

Autor: Marilyn Achiron, përditësuar nga Radha Govil

Bordi Editorial për edicionin e dytë:

UNHCR: Mark Manly, Radha Govil, Janice L Marshall dhe José Riera

UNP: Anders B. Johnsson, Kareen Jabre dhe Norah Babic

Varianti origjinal: Anglisht

Grafika e kopertinës nga “Imprimerie Centrale”, Luksemburg

Parathënie

Që kur edicioni i parë i këtij Doracaku u botua në vitin 2005, parlamentarët kanë kontribuar në mënyrë të vazhdueshme për përparimin e konsiderueshëm të arritur në përgjigjen botërore ndaj pashtetësisë. Norma e aderimeve tek të dy Konventat e Kombeve të Bashkuara për pashtetësinë ka pësuar një përshtetje të mprehtë dhe një prirje drejt reformimit të ligjeve të shtetësisë për të parandaluar shtimin e rasteve të reja dhe për të zgjidhur situatat e zgjatura të pashtetësisë. Gjithashtu ka pasur edhe një rritje në përpjekjet për forcimin e regjistrimit civil dhe sistemeve të dokumentimit të shtetësisë.

Megjithatë problemi i pashtetësisë vazhdon, dhe Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) vlerëson se ajo ende ndikon tek të paktën 10 milion njerëz në mbarë botën. Çdo vit, dhjetëra mijëra fëmijë lindin pa shtetësi sepse prindërit e tyre janë pa shtetësi. Pashtetësia mund të ndodhë si rezultat i diskriminimit dhe privimit arbitrar të shtetësisë, situatat e ecurisë normale të shtetit, praktikat e papërshtatshme të regjistrimit civil, probleme në marrjen e dokumenteve që vërtetojnë shtetësinë dhe mangësi të tjera në ligjet e shtetësisë.

Një person pa shtetësi është dikush që nuk është i njohur si një shtetas i ndonjë vendi dhe pashtetësia ka një ndikim të vërtetë dhe shkatërrues në jetën e individëve, familjeve dhe komuniteteve të tyre. Shtetësia jo vetëm siguron njerëzit me një ndjenjë të identitetit dhe përkatësisë, por është gjithashtu e rëndësishme për mbrojtjen e plotë shtetërore dhe gëzimin e shumë të drejtave të njeriut, duke përfshirë arsimin, kujdesin shëndetësor, punësimin ligjor, pronësinë, pjesëmarrjen politike dhe lirinë e lëvizjes. Në të vërtetë, rëndësia themelore e të drejtës së shtetësisë është e njohur në Nenin 15 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, si edhe në një numër të traktateve të ratifikuara gjerësisht të të drejtave të njeriut. Në raste të pazgjidhura, pashtetësia mund të krijojë tensione sociale, në mënyrë të konsiderueshme të dëmtojë përpjekjet për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe social dhe madje edhe të çojë në konflikt të dhunshëm dhe zhvendosje të popullsisë.

Ndërkohë që një pjesë e personave pa shtetësi janë të detyruar të ikin dhe të bëhen refugjatë, shumica mbeten në vendet në të cilat ata kanë lindur dhe kanë jetuar gjithë jetën e tyre. Më shumë duhet bërë për të lehtësuar gjendjen e vështirë të atyre që jetojnë në situata të zgjatura në shkallë të gjerë të pashtetësisë me implikime të thella për të drejtat e tyre njerëzore. Vullneti politik dhe veprimi i përbashkët nga qeveritë janë të rëndësishme për zgjidhjen e kësaj çështje.

Publikimi i këtij manuali përkon me nisjen nga UNHCR të një fushate 10-të vjeçare për t'i dhënë fund pashtetësisë. Përpjekjet nga parlamentarët do të jenë vendimtare për arritjen e këtij qëllimi ambicioz. Parlamentarët mund të ndihmojnë për ti dhënë fund pashtetësisë duke rregulluar dhe siguruar zbatimin e legjisllacionit të brendshëm që është në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Ligjet mbi shtetësinë kanë nevojë për të siguruar që individët nuk janë të privuar arbitrarisht nga shtetësia; që burrat dhe gratë të gëzojnë barazi në çështjet e shtetësisë; dhe se fëmijëve u është dhënë një shtetësi në rrethana të cilat shmangin pashtetësinë. Parlamentarët gjithashtu mund të promovojnë pranimin nga shtetet e tyre të të dy konventave të pashtetësisë së Kombeve të Bashkuara, të cilat ofrojnë kornizën për një përgjigje të përbashkët ndërkombëtare të problemit.

Ky manual i rishikuar mbi shtetësinë dhe pashtetësinë, prodhuar së bashku nga Bashkimi Ndër-Parlamentar dhe UNHCR, ofron një informacion të çmuar mbi çështjet bashkëkohore të pashtetësisë, zhvillimet në doktrinën ligjore ndërkombëtare, shembuj të praktikave më të mira dhe zgjidhjet e mundshme. Ai gjithashtu rekomandon veprimet që mund të ndërmerren nga parlamentarët, zyrtarët e qeverisë, organizatat e shoqërisë civile dhe të tjerë aktorë për të adresuar sfidat e pashtetësisë. Ne jemi të sigurt se ai do të shërbejë si një mjet i dobishëm për të reduktuar dhe në fund të fundit për të zhdukur problemin e pashtetësisë, duke eliminuar ndikimin e tij shkatërrues mbi miliona gra, burra, vajza dhe djem.



Anders B. Johnsson
Sekretari i Përgjithshëm
Bashkimi Ndër-Parlamentar



António Guterres
Komisioner i Lartë i
Kombeve të Bashkuara për Refugjatët

Hyrje

Ne që jemi shtetas të një vendi zakonisht i marrim të mirëqena të drejtat dhe detyrimet që shtetësia vendos mbi ne. Shumica prej nesh mund t'i regjistrojnë fëmijët në shkollë, të kërkojmë kujdes shëndetësor kur jemi të sëmurë, të aplikojmë për punë kur kemi nevojë dhe të votojmë për të zgjedhur përfaqësuesit tanë në qeveri. Ne ndiejmë se kemi një interes në vendin ku jetojmë; ne ndiejmë një ndjesi të thellë të përkatësisë tek diçka më e madhe se vetja jonë.

Por si është jeta për njerëzit të cilët nuk kanë një status shtetësie dhe të cilët janë pa të drejtën e shtetësisë? Pa pasur shtetësinë një person nuk mund të regjistrohet për të votuar në vendin ku ai/ajo jeton, nuk mund të aplikojë për dokumente udhëtimi, nuk mund të regjistrohet për martesë, etj. Në disa raste individët që janë pa shtetësi dhe janë jashtë vendit të tyre të origjinës, ose vendit të mëparshëm të banimit, mund të mbahen të ndaluar për periudha të gjata nëse ato vende refuzojnë t'i lejojnë atyre rihyrjen në territoret e tyre. Shpesh edhe të drejtat më themelore si të drejtat për arsimim, kujdes shëndetësor dhe punësim u mohohen individëve të cilët nuk mund të provojnë një lidhje ligjore me një vend të caktuar.

Asnjë rajon në botë nuk është i çliruar nga problemet që çojnë tek pashtetësia. Megjithatë numri i saktë i personave pa shtetësi kudo në botë është ende i panjohur. Shtetet shpesh nuk kanë vullnet ose nuk janë në gjendje të ofrojnë të dhëna të sakta, pak prej tyre kanë mekanizma për regjistrimin e personave pa shtetësi dhe personat pa shtetësi shpesh nuk dëshirojnë të identifikohen për shkak të vendbanimeve të pasigurta. Së fundmi një numër i madh shtetesh po punojnë me UNHCR-në për të matur numrin e personave pa shtetësi në territoret e tyre. UNHCR-ja vlerëson se miliona njerëz kudo në botë jetojnë pa një shtetësi efektive.

Pashtetësia, e cila fillimisht është njohur si problem botëror gjatë gjysmës së parë të shekullit të XX, mund të vijë si rezultat i mosmarrëveshjeve mesh shteteve në lidhje me identitetin juridik të individëve, pamundësisë së shtetit për të ekzistuar, marginalizimit të tejzgatur të grupeve specifike brenda shoqërisë ose i heqjes së shtetësisë nga individë apo grupe të caktuara. Pashtetësia normalisht shoqërohet me periudha të ndryshimeve të thella në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ripërcaktimi i kufijve ndërkombëtarë, manipulimi i sistemeve politike nga udhëheqësit vendas me qëllim arrijen e rezultateve politike të diskutueshme, dhe/ose mohimi ose privimi i shtetësisë për të përjashtuar

“Duke m’u thënë ‘Jo’ nga vendi ku unë jetoj; duke m’u thënë ‘Jo’ nga vendi ku kam lindur; duke m’u thënë ‘Jo’ nga vendi nga i cili janë prindërit e mi; duke dëgjuar ‘ti nuk na përket ne’ vazhdimisht!, unë ndiej se jam askush dhe as nuk e di përse jetoj. Duke qenë pa shtetësi, ti je gjithmonë i /e rrethuar nga një ndjesi e të qenit i palverë.”

Lara, që ka qenë

më parë pa shtetësi

dhe marginalizuar minoritete raciale, fetare apo etnike kanë rezultuar me mungesën e shtetësisë në çdo rajon të botës. Gjatë 20 viteve të fundit një numër gjithnjë e në rritje njerëzish janë privuar nga shtetësia e tyre ose nuk kanë qenë në gjendje për të fituar një shtetësi efektive. Nëse këto situata lejohen të vazhdojnë, ndjenja e thellë e heqjes së shtetësisë si një e drejtë legjitime në popullatat e prekura mund të çojë eventualisht tek shpërngulja e tyre.

Ky doracak synon t'u ofrojë parlamentarëve një përshkrim të gjerë të parimeve ndërkombëtare që rregullojnë shtetësinë dhe pashtetësinë. E drejta ndërkombëtare u jep shteteve kompetenca të gjera për të përkufizuar tërësinë e tyre fillestare të shtetasve dhe kushtet për fitimin, humbjen dhe mbajtjen e shtetësisë. Megjithatë parimet e të drejtave të njeriut të zhvilluara gjatë shekullit të XX e kufizojnë këtë hapësirë, nëse ajo çon tek mungesa e shtetësisë dhe/ose nëse aplikohet në mënyrë diskriminuese.

Ndërsa shtetet punojnë së bashku për të trajtuar problemet e lidhura me pashtetësinë, ka ende miliona individë rreth e rrotull botës, të cilët nuk kanë një shtetësi efektive. Ky doracak diskuton të drejtat dhe detyrimet e personave pa shtetësi siç mbrohen nga e drejta ndërkombëtare, sidomos nga Konventa e 1954 në lidhje me Statusin e Personave Pa Shtetësi, si edhe nënvizon arsyet kryesore të pashtetësisë duke sugjeruar masat sesi qeveritë mund të bëjnë të mundur që zbatimimi i legjislacionit të tyre ndërkombëtar të mos rezultojë në fenomenin e pashtetësisë.

UNHCR është Agjencia e Kombeve të Bashkuara e ngarkuar për të ndihmuar reduktimin e rasteve të pashtetësisë dhe për të ndihmuar ata individë që janë pa shtetësi në sigurimin e një tille. Ky doracak përshkruan çfarë bën UNHCR-ja për të përmbushur këtë rol. Ai gjithashtu sugjeron hapa praktike që parlamentarët mund të marrin për të ndihmuar në reduktimin e rasteve të shpeshta të pashtetësisë, që nga shqyrtimi dhe, nëse është e nevojshme, rishikimi i ligjeve të shtetësisë të vendit të tyre, inkurajimi i qeverive për të aderuar në traktatet ndërkombëtare mbi pashtetësisë, si edhe rritja e ndërgjegjësimit të publikut për problemet që lidhen me pashtetësinë.

Ky doracak gjithashtu ofron shembuj pozitivë sesi situata të tejzgjatura të mungesës së shtetësisë janë zgjidhur falë vullnetit politik të shteteve të përfshira, angazhimit të shoqërisë civile dhe ndihmës së ofruar nga komuniteti ndërkombëtar. Këto "praktika të mira" ilustrjnë që kur qeveritë, shoqëria dhe komuniteti ndërkombëtar punojnë bashkë, individët pa shtetësi më në fund mund të gëzojnë "të drejtën për të pasur një shtetësi".

"Të zhvishesh nga shtetësia është si të zhvishesh nga përkatësia tek bota; është si të kthehesh në gjendje të egër si njeri i shpellave ose primitiv. Një njeri që nuk është asgjë përveçse një njeri që ka humbur cilësitë e vërteta që i mundësojnë njerëzit e tjerë ta trajtojnë atë si njeri, ata mund të lindin dhe vdesin pa lënë ndonjë gjurmë, pa kontribuar asgjë tek bota e përbashkët."

Hannah Arendt, *Origjinat e Totalitarizmit*

(The Origins of

Totalitarianism)

Korniza ligjore ndërkombëtare për të drejtën e shtetësisë dhe reduktimin e pashtetësisë.



Disa qindra mijëra Rohingya pa shtetësi nga Mianmari jetojnë në zonën bregdetare të Shamlapur, Bangladesh. Shumë prej tyre janë bllokuar në skllavëri prej borxhit ndaj pronarëve të anijeve, borxhe që rriten nga viti në vit. © UNHCR / Greg Konstandini, 2010

Shtetësia është një çështje tejet e ndjeshme, pasi është manifestimi i sovranitetit dhe identitetit të një vendi. Nuk është për t'u habitur që mosmarrëveshjet në lidhje me qytetarinë mund, dhe madje shpesh, të rezultojnë në tensione dhe konflikte, si brenda ashtu dhe ndërmjet shteteve. Gjatë shekullit të XX ka pasur një rritje si të shpeshtësisë së rasteve të pashtetësisë në botë, si dhe rritje të ndërgjegjësimit dhe shqetësimit për të drejtat e njeriut. E drejta ndërkombëtare mbi shtetësinë ka evoluar në dy drejtime; duke mbrojtur dhe ndihmuar ata individë që kanë qenë pa shtetësi, dhe duke u përpjekur për të eliminuar, ose të paktën për të zvogëluar shpeshtësinë e rasteve të pashtetësisë.

Kush përcakton nëse një person është shtetas i një vendi të caktuar?

Në parim pyetjet e shtetësisë bien nën juridiksionin e brendshëm të çdo shteti. Megjithatë, zbatueshmëria e vendimeve të brendshme të një shteti mund të kufizohet nga veprime të ngjashme të shteteve të tjera dhe nga e drejta ndërkombëtare.

Në opinionin e saj këshillimor mbi Dekretet e Shtetësisë të Tunizisë dhe Marokut të vitit 1923, Gjykata e Përhershme Ndërkombëtare e Drejtësisë deklaroi se:

“Pyetja nëse një çështje e caktuar është ose nuk është vetëm brenda juridiksionit të një shteti është një pyetje thelbësore relative; ajo varet nga zhvillimet e marrëdhënieve ndërkombëtare.”

Në fakt Gjykata e Përhershme tha se ndërsa çështjet e shtetësisë ishin në parim të juridiksionit të brendshëm, shtetet megjithatë duhet të respektojnë detyrimet e tyre ndaj shteteve të tjera ashtu siç rregullohen nga rregullat e të drejtës ndërkombëtare.

Kjo qasje është përsëritur shtatë vite më pas në Konventën e Hagës të vitit 1930 Mbi disa çështje në lidhje me konfliktin e ligjeve të shtetësisë (Konventa e Hagës 1930). Në të vërtetë shumë shtete e komentuan opinionin këshillimor të Gjykatës së Përhershme të vitit 1923 si të lidhur me përgatitjet për Konventën e Hagës së 1930 mbi Shtetësinë. Shumica e shteteve e interpretuan opinionin këshillimor si kufizim të zbatueshmërisë së vendimeve të një shteti të lidhura me shtetësinë jashtë atij shteti, sidomos kur këto vendime binin në konflikt me vendimet që lidhen me vendimet e shtetësisë të bëra nga shtetet e tjera.

Konventa e Hagës e vitit 1930 mbi Shtetësinë, e mbajtur nën drejtimin e Asamblesë së Lidhjes së Kombeve, ishte përpjekja e parë ndërkombëtare për të siguruar që të gjithë personat të kenë një shtetësi. Neni 1 i Konventës deklaroi se:

“I takon çdo shteti të vendosë sipas së drejtës së tij se cilët janë shtetasit e tij. Kjo e drejtë duhet të njihet nga të gjitha shtetet e tjera për aq kohësa kjo është në pajtueshmëri me konventat ndërkombëtare, ligjet ndërkombëtare dhe parimet e përgjithshme të së drejtës të njohura në lidhje me shtetësinë.”

Me fjalë të tjera mënyra sesi shteti e ushtron të drejtën e tij për të vendosur për shtetasit e tij duhet të jetë në pajtim me dispozitat përkatëse të së drejtës ndërkombëtare.

Neni 15 i Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) të vitit 1948 deklaroi se:

“Çdo njeri ka të drejtën e shtetësisë. Askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga shtetësia e tij, ose t'i mohohet e drejta për të ndryshuar shtetësinë e tij.”

Kjo e drejtë bazohet në ekzistencën e një lidhjeje të pastër dhe efektive mes një individi dhe një shteti. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë shpjegoi shtetësinë dhe lidhjet e saj sipas formulimit të mëposhtëm në vitin 1955, në rastin "Nottebohm":

"Sipas praktikës së shteteve, vendimeve arbitrare dhe gjyqësore si edhe opinionit të shkrimtarëve, shtetësia është lidhja juridike që ka në bazë të saj një fakt social të përkatësisë, një lidhje të pastër të ekzistencës, interesit dhe ndjenjave, së bashku me ekzistencën e të drejtave dhe detyrimeve reciproke."

Një lidhje e pastër dhe efektive, e cila ngre të drejtën e shtetësisë, manifestohet me anë të lindjes, rezidencës, dhe/ose trashëgimisë dhe tashmë është e gjithashtu reflektuar në dispozitat dhe legjislacionin për shtetësinë e shteteve si dhe në instrumentet më të fundit ndërkombëtare mbi shtetësinë, si Konventa Evropiane për Shtetësinë e vitit 1997 (KESht).

Shtetësia është përkufizuar nga Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut si:

"Lidhja politike dhe juridike që bashkon një person me një shtet të caktuar dhe e detyron atë ndaj tij me lidhjet e lojalitetit dhe besnikërisë, që i japin atij të drejtën e mbrojtjes diplomatike nga ai shtet" (Castillo-Petrucci et al v. Peru, Vendimi i Majit 1999, IACHR (sek. C) Nr. 52 1999).

Si mbrohen të drejtat e refugjatëve dhe të personave pa shtetësi?

Megjithëse neni 15 i Deklaratës Universale së të Drejtave të Njeriut pohon se çdo person ka të drejtën e një shtetësie, ai nuk e përshkruan shtetësinë specifike që i takon një personi. Për të siguruar që personat nuk janë të privuar nga një minimum i caktuar i të drejtave që lidhen me shtetësinë, komuniteti ndërkombëtar hartoi dy traktate: Konventa e vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatit (Konventa e Refugjatit e vitit 1951) dhe Konventa e vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave Pa Shtetësi (Konventa e vitit 1954).

A ka ndonjë lidhje mes Konventës së vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatit dhe çështjes së pashtetësisë?

Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore një prej çështjeve më të ngutëshme për shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara të krijuara rishtazi ishte trajtimi i nevojave të miliona individëve, të cilët lufta i kishte lënë si refugjatë, ose i kishte lënë pa shtetësi. Një rezolutë e vitit 1949 e Këshillit Ekonomiko-Social të Kombeve të Bashkuara (ECOSOC) çoi drejt krijimit të një Komiteti Ad Hoc, detyra e të cilit ishte të shqyrtonte formulimin e një Konvente mbi statusin e refugjatëve dhe personave pa shtetësi si edhe të shqyrtonte propozimet për eliminimin e pashtetësisë.

Në fund anëtarët e Komitetit hartuan një Konventë mbi statusin e refugjatëve dhe një Protokoll tek Konventa e propozuar që fokusohet tek personat pa shtetësi. Komiteti nuk e trajtoi plotësisht eliminimin e pashtetësisë, kjo në një masë të madhe për faktin se supozohej se Komisioni i formuar rishtazi i të Drejtës Ndërkombëtare (ILC) do të fokusohet në atë çështje.

Historikisht të dy grupet, refugjatët dhe personat pa shtetësi, kanë përfutur mbrojtje dhe ndihmë nga organizatat ndërkombëtare të refugjatëve që i kanë paraprirë UNHCR-së. Draft Protokollin mbi Pashtetësinë kishte si synim të reflektonte këtë lidhje mes refugjatëve dhe personave pa shtetësi. Por nevojat urgjente të refugjatëve dhe shpërbërja e rrezikuar e Organizatës Ndërkombëtare të Refugjatit do të thoshin se nuk kishte kohë të mjaftueshme

për një analizë të hollësishme të situatës së personave pa shtetësi në Konferencën Fuqiplotë të vitit 1951 që u mbledh për të shqyrtuar të dyja çështjet. Për rrjedhojë Konventa në lidhje me Statusin e Refugjatit e vitit 1951 u përshtat në Konferencë, ndërsa miratimi i Protokollit lidhur me trajtimin e personave pa shtetësi u shty për në një datë të mëvonshme.

Një personi pa shtetësi mund t'i ofrohet mbrojtje sipas Konventës së Refugjatit të vitit 1951. Një refugjat pa shtetësi përfiton mbrojtje si refugjat, pasi mohimi arbitrar i shtetësisë së tij për shkak të racës, besimit, kombësisë, anëtarësimit në një grup të caktuar shoqëror, ose opinionit politik, mund të tregojë që individi duhet të njihet si refugjat.

Çfarë ofron Konventa e vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave Pa Shtetësi?

Protokollin mbi personat pa shtetësi, që është përpiluar si shtojcë e Konventës së Refugjatit të vitit 1951, u transformua në një Konventë me të gjitha të drejtat e saj në vitin 1954. Konventa e vitit 1954 është instrumenti ndërkombëtar parësor që synon të rregullojë dhe përmirësojë statusin e personave pa shtetësi dhe që të sigurojë që personave pashtetësi u janë dhënë të drejtat dhe liritë e tyre themelore pa diskriminim. (Shih Shtojcën një për një listë të shteteve palë të Konventës së vitit 1954.)

Dispozitat e Konventës mbi Statusin e Personave Pa Shtetësi janë në shumë drejtime tepër të ngjashme me ato të Konventës së Refugjatit të vitit 1951. Aderimi në Konventën e vitit 1954 nuk është zëvendësim për dhënien e shtetësisë ndaj atyre që kanë lindur dhe janë rezidentë të zakonshëm në territorin e një shteti. Pavarësisht sesa të gjera mund të jenë të drejtat që i jepen një personi pa shtetësi, ato nuk janë të barazvlefshme me fitimin e shtetësisë.

Neni 1(1) i Konventës së vitit 1954 përfshin përkufizimin e njohur ndërkombëtarisht ligjor të personit pa shtetësi:

“një person, i cili nuk konsiderohet si shtetas i asnjë shteti në bazë të veprimit të ligjeve të tij”

Personat që bien në fushëveprimin e nenit 1 (1) të Konventës së vitit 1954 referohen disa herë si “de jure” persona pa shtetësi. Ndryshe nga sa më lart një referenca e personave pa shtetësi “de facto” i jepet në Aktin Final. Termi person pa shtetësi “de facto” nuk përkufizohet në ndonjë dokument ndërkombëtar dhe nuk ka regjim traktat specifik për këtë kategori personash. Përkufizimi që përdoret në punën e UNHCR-së për personat “de facto” pa shtetësi lidhet me personat që janë jashtë vendit të tyre, të cilët nuk janë në gjendje apo, për arsye të vlefshme, nuk janë të gatshëm të përfitojnë nga mbrojtja diplomatike e atij vendi.

Kush është shtetas? Kush është pa shtetësi?

Për t'u konsideruar shtetas në bazë të veprimit të ligjit do të thotë që një individ është automatikisht i quajtur shtetas sipas kushteve të parashtruara në instrumentet ligjore të miratuara të shtetit që lidhen me shtetësinë, ose që individit i është dhënë shtetësia me anë të një vendimi të marrë nga autoritetet kompetente. Shumica e njerëzve konsiderohen shtetas nga veprimi i ligjeve të vetëm një shteti - zakonisht ose nga ligjet e shtetit ku personi ka lindur (jus soli), ose ligjet e shtetit ku prindërit e personit ishin shtetas kur ka lindur personi (jus sanguinis).

Sa herë një procedurë administrative jep liri veprimi në dhënien e shtetësisë, aplikantët nuk mund të konsiderohen si shtetëas derisa aplikimet e tyre të jenë plotësuar dhe miratuar dhe shtetësia e atij shteti të jetë dhënë në përputhje me ligjin. Për individët që ligji përcakton se mund të aplikojnë, por ndërkohë aplikimet e tyre rrëzohen nga autoritetet, atëherë ata nuk konsiderohen shtetas të atij shteti me anë të veprimit të ligjit të tij.

Doracaku i UNHCR-së për Mbrojtjen e Personave pa Shtetësi ofron udhëzime për Shtetet, UNHCR-në dhe aktorë të tjerë se si të interpretojnë nenin 1(1) të Konventës së vitit 1954 mbi Statusin e Personave pa Shtetësi për të lehtësuar identifikimin dhe trajtimin e duhur të përfituesve të kësaj Konvente.

Edhe pse Konventa e vitit 1954 përcakton përkufizimin ligjor ndërkombëtar të një "personi pa shtetësi" dhe standardet e trajtimit për të cilat individët e tillë kanë të drejtë, ajo nuk përshkruan asnjë mekanizëm për të identifikuar personat pa shtetësi. Megjithatë, është e nënkuptuar në Konventën e vitit 1954 që Shtetet duhet të identifikojnë personat pa shtetësi brenda juridiksioneve të tyre në mënyrë që tu sigurojnë atyre trajtimin e duhur për të përmbushur angazhimet e tyre të Konventës. Doracaku i UNHCR-së për Mbrojtjen e Personave pa Shtetësi ofron udhëzime për shtetet dhe UNHCR-në në krijimin e procedurave kombëtare të cilat kanë për qëllim në mënyrë specifike përcaktimin nëse një person është pa shtetësi. Nëpërmjet përfaqësive / zyrave ose shërbimeve të saj në Zyrat Qendrore, UNHCR-ja është në dispozicion për të ofruar këshilla se si për të krijuar dhe zbatuar këto procedura, nëse kërkohen nga shtetet.

A mundet që një person pa shtetësi të jetë edhe refugjat?

Edhe pse shumica e njerëzve pa shtetësi në mbarë botën jetojnë në vendin në të cilin ata kanë lindur, një numër i konsiderueshëm janë larguar nga vendet e tyre për të shpëtuar persekutimit për arsye të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose mendimit politik. Njerëz të tillë janë refugjatë pa shtetësi.

E ndarë më vete, pashtetësia në përgjithësi nuk përbën persekutim nën përkufizimin e refugjatit të përcaktuar në Konventën për Refugjatit e vitit 1951, por ajo mund të jetë një element i persekutimit marrë në mënyrë të përmbledhur me faktorë të tjerë. Heqja arbitrare e shtetësisë mbi baza diskriminuuese mund të krijojë shkaqe për një frikë të bazuar mbi persekutimin, veçanërisht kur ajo rezulton në pashtetësi.

Hartuesit e Konventës së Refugjatëve të vitit 1951 për Statusin e Personave pa Shtetësi dhe Konventës së vitit 1954 mbi Reduktimin e Pashtetësisë vendosën të krijojnë dy regjime të veçanta ligjore për të mbrojtur refugjatët dhe personat pa shtetësi. Ndërsa Konventa e Refugjatit e vitit 1951 mbulon refugjatët, duke përfshirë edhe ata që janë gjithashtu pa shtetësi, Konventa e vitit 1954 është projektuar për personat pa shtetësi të cilët nuk janë refugjatë.

Shumica e të drejtave të dhëna për personat pa shtetësi në bazë të Konventës së 1954 mbi Statusin e Personave pa Shtetësi janë të njëjta me ato që u jepen refugjatëve sipas Konventës së Refugjatit të vitit 1951. Megjithatë, për shkak të situatës specifike të refugjatëve, Konventa e Refugjatit e vitit 1951 përmban referencë specifike për mospenalizimin ndaj hyrjes apo pranisë së parregullt/paligjshme si dhe ndaj moskthimit. Këto parime nuk janë të përfshira në Konventën e vitit 1954. Si e tillë, në qoftë se një person kualifikohet për të dy statutet; atë të refugjatit dhe atë të pashtetësisë, shteti duhet të zbatojë për të dispozitat më të favorshme të Konventës së Refugjatit të vitit 1951.

Çfarë ofron Konventa e vitit 1961 mbi Reduktimin Pashtetësisë?

Për shkak të qasjeve të ndryshme të marra nga shtetet në lidhje me fitimin dhe humbjen e shtetësisë, disa individë vazhdojnë të “bien në situata ngërçesh ligjore” dhe kthehen në persona pa shtetësi. Rregullat e përbashkëta për këtë arsye janë thelbësore për të adresuar boshllëqe të tilla.

Në vitin 1950, Komisioni për Ligjin Ndërkombëtar (KLN) filloi procesin e hartimit të asaj që më vonë do të shfaqej si Konventa e vitit 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë (Konventa e Pashtetësisë së vitit 1961). Konventa e vitit 1961 është i vetmi instrument universal që zhvillon dhe ofron masa të qarta, të hollësishme dhe konkrete për të siguruar një përgjigje të drejtë dhe të përshtatshme ndaj kërcënimit të pashtetësisë.

Nenet e Konventës së vitit 1961 synojnë të shmangin pashtetësinë në lindje dhe në faza të mëvonshme në jetë, por ata as nuk ndalojnë mundësinë e heqjes së shtetësisë në rrethana të caktuara, e as u kërkojnë Shteteve t’u japin shtetësinë të gjithë personave që aktualisht janë pa shtetësi.

Konventa e vitit 1961 gjithashtu parashikon krijimin e një organi në të cilin personat të cilët mund të përfitojnë nga dispozitat e Konventës së vitit 1961 të mund të aplikojnë që kërkesa e tyre të vlerësohet si edhe të kërkojnë ndihmë në paraqitjen e kërkesës tek autoriteti i duhur. Në vijim Asambleja e Përgjithshme i kërkoi UNHCR-së ta përmbushë këtë rol. (Shih Shtojcën 2 për një listë të Shteteve Palë të Konventës së vitit 1961.)

Në përpjekje për të reduktuar rastet e shumta të pashtetësisë, Konventa e vitit 1961 kërkon që shtetet palë të rregullojnë legjislacionin mbi shtetësinë që reflekton standardet e përshkruara në lidhje me fitimin ose humbjen e shtetësisë. Në rast lindje të mosmarrëvshjeve e në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Konventës mes shteteve kontraktuese, e pamundësisë për t’l zgjidhur ato me mjete të tjera, shtetet mund t’l drejtohen Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesën e çdo njëres prej palëve në mosmarrëveshje.

Doracakut i UNHCR-së për Mbrojtjen e Personave pa Shtetësi ofron udhëzime për qeveritë, UNHCR-në dhe aktorët e tjerë se si të interpretojë dhe zbatojnë Nenet 1 - 4 dhe 12 të Konventës për Reduktimin e Pashtetësisë, së vitit 1961 që kanë të bëjnë me shmangien e pashtetësisë tek fëmijëve.

“Një ditë unë isha duke qëndruar në mes dy kufijve, dhe nuk mund të hyja në asnjërin prej vendeve. Ishte përvoja më e paharrueshme e jetës sime. Unë s’mund të hyja në vendin ku kisha qenë; edhe as nuk mund të hyja në shtetin ku kisha lindur, isha rritur dhe kisha jetuar! Cilit vend i përkas unë? Ende s’mund ta harroj ndjenjën e fortë të humbjes që përjetova në aeroport.”

Laura, që ka qenë më parë pa shtetësi

Si e garanton ligji për të drejtat e njeriut të drejtën e shtetësisë?

Instrumente të tjera ligjore ndërkombëtare adresojnë të drejtën për një shtetësi. Neni 15 i **Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ)** parashikon se çdokush ka të drejtën e një shtetësie dhe se askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga shtetësia e tij.

E drejta e çdo fëmije për të fituar një shtetësi u ngrit në vijim si çështje edhe në Paktin e vitit 1966 mbi të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR). Neni 24 thotë se:

“Çdo fëmijë duhet të ketë, pa asnjë diskriminim ndaj racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, origjinës kombëtare ose sociale, pasurisë ose lindjes, të drejtën për masa të tilla mbrojtëse që kërkojnë kushtet e tij si i mitur, nga ana e familjes së tij, shoqërisë dhe shtetit.”

“Çdo fëmijë duhet të regjistrohet menjëherë pas lindjes dhe duhet të ketë një emër.”

“Çdo fëmijë ka të drejtë për të fituar një shtetësi.”

Neni 26 i Paktit mbi të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966 (PDCP) gjithashtu përcakton një masë për mos-diskriminimin e cila mund të zbatohet në një fushë shumë të gjerë, duke përfshirë legjislacionin për shtetësinë dhe mënyrën se si ai është zbatuar:

“Të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë nga ligji. Në këtë drejtim, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe t’u garantojë të gjithë njerëzve mbrojtje të barabartë dhe efektive kundër diskriminimit të çdo lloji të bazuar në shkaqe të tilla si raca, ngjyra, seksi, gjuha, besimi fetar, opinioni politik ose tjetër, origjina kombëtare ose sociale, pasuria, lindja ose statuse të tjera.”

Konventa 1965 për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (KEFDR) detyron shtetet të “garantojnë të drejtën e të gjithëve, pa dallim race, ngjyre, apo origjine kombëtare ose etnike, si të barabartë përpara ligjit,” veçanërisht në gëzimin e disa të drejtave themelore të njeriut, përfshirë këtu të drejtën e kombësisë (neni 5).

Neni 9 i Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave të vitit 1979 adreson një shkak madhor të pashtetësisë – diskriminimi kundër grave në ligjet vendase për shtetësinë – duke deklaruar se:

“Shtetet palë duhet t’u japin grave të drejta të barabarta me burrat për të fituar, ndryshuar apo mbajtur shtetësinë e tyre. Ata duhet të sigurojnë në veçanti që as martesë me një të huaj e as ndryshimi i shtetësisë nga bashkëshorti gjatë martesës nuk duhet të ndryshojë automatikisht shtetësinë e bashkëshortes, ta lërë atë pa shtetësi ose të detyrojë mbi të shtetësinë e bashkëshortit.”

“Shtetet duhet t’u japin grave të drejta të barabarta me burrat në lidhje me shtetësinë e fëmijëve të tyre”

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës e vitit 1989 (KDF), e cila është ratifikuar nga pothuajse çdo shtet, përmban dy nene të rëndësishme në lidhje me shtetësinë:

Neni 2 parasheh se:

“Shtetet palë duhet të respektojnë dhe garantojnë të drejtat e parashtruara në Konventë për çdo fëmijë brenda juridiksionit të tyre pa diskriminim të ndonjë lloji, pavarësisht nga raca, ngjyra, seksi, gjuha, besimi, opinioni politik ose tjetër, origjina kombëtare, etnike ose sociale, pasuria, paaftësia, lindja ose statusi tjetër i fëmijës, prindërve të tij ose të saj, ose kujdestarit të tij ose të saj ligjor”

Neni 7 përcakton se:

“Çdo fëmijë duhet të regjistrohet menjëherë pas lindjes dhe duhet të ketë të drejtën e emrit që nga lindja, të drejtën të fitojë një shtetësi dhe për sa është e mundur, të drejtën për të njohur dhe për të pasur kujdesin e prindërve të tij ose të saj.”

Neni 8 (1) parashikon se:

“Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij ose të saj, duke përfshirë shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, siç njihet nga ligji dhe pa ndërhyrje të paligjshme.”

Neni 29 i Konventës mbi Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre të vitit 1990 thekson se:

“Çdo fëmijë i një punëtori migrant ka të drejtën për një emër, për regjistrimin e lindjes dhe të një kombësie.”

Neni 18 i Konventës së vitit 2006 mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara deklaron se:

“1. Shtetet Palë njohin të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për lirinë e lëvizjes, lirinë për të zgjedhur vendbanimin e tyre dhe shtetësinë, në baza të barabarta si të tjerët, duke përfshirë edhe duke siguruar se personat me aftësi të kufizuara:

(a) Kanë të drejtë të marrin dhe ndryshojnë shtetësinë dhe nuk janë të privuar nga shtetësia e tyre në mënyrë arbitrare apo në bazë të aftësisë së kufizuar;

2. Fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të regjistrohen menjëherë pas lindjes dhe kanë të drejtë që nga lindja për një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, sa më shumë të jetë e mundur, të drejtën për tu njohur dhe përkujdes nga prindërit e tyre.

A ka traktate rajonale që trajtojnë të drejtën për një shtetësi?

Instrumentet rajonale përforcojnë bazën ligjore të së drejtës për shtetësi. Neni 20 i Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut e vitit 1969 jo vetëm që i referohet të drejtës për shtetësi, por përfshin edhe një masë të veçantë për të mbrojtur fëmijët nga shndërrimi në pa shtetësi:

“Çdo person ka të drejtën e një shtetësie. Çdo person ka të drejtën e shtetësisë së shtetit në territorin e të cilit ka lindur nëse nuk ka të drejtën e një shtetësie tjetër. Askush nuk mund të privohet arbitrarisht nga shtetësia e tij ose e drejta për ta ndryshuar atë.”

Këto parime menjëherë më pas, janë mbështetur nga jurisprudenca e Gjykatës Ndër-Amerikane. Ndërsa Gjykata ka konfirmuar se kushtet sipas të cilave jepet shtetësia, mbeten brenda juridiksionit të brendshëm të shtetit. Gjykata doli në përfundimin gjithashtu se:

“Pavarësisht faktit se është tradicionalisht e pranuar se dhënia dhe njohja e shtetësisë janë çështje për t’u vendosur nga çdo shtet, zhvillimet e bashkëkohore tregojnë se e drejta ndërkombëtare vendos disa kufij mbi pushtetin e gjerë që gëzojnë shtetet në këtë fushë dhe se mënyra sesi shtetet i rregullojnë çështjet që kanë lidhje me shtetësinë sot nuk mund konsiderohen se janë vetëm brenda juridiksionit të tyre.” (Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut, Opinioni Këshillimor, Shtojcat tek Dispozitat e Natyralizimit të Kushtetutës së Kosta Rikës, “ paragrafët 32-34; teksti në 5 HRLJ 1984.)

Me fjalë të tjera, shtetet duhet të marrin në konsideratë jehonën ndërkombëtare të legjislacionit të tyre të brendshëm mbi shtetësinë, veçanërisht nëse aplikimi i atij legjislacioni mund të rezultojë në pashtetësi.

Konventa Evropiane për Shtetësinë (ECN), një instrument rajonal i hartuar nga Këshilli i Evropës, ka lindur nga nevoja e perceptuar për të krijuar një tekst të vetëm që të konsolidojë të gjitha zhvillimet në të drejtën e brendshme dhe ndërkombëtare përsa i përket shtetësisë që prej kohës kur Konventa e Hagës e vitit 1930 trajtoi çështjen e konfliktit të ligjeve të shtetësisë. Në dallim nga traktatet më të hershme të miratuara në Evropë, ajo gjithashtu lejon fitimin e shtetësisë të shumta për personat e martuar të shtetësisë të ndryshme dhe fëmijët e tyre. ECN gjithashtu mbulon pyetjet për fitimin, mbajtjen, humbjen dhe kthimin

“Ndonjëherë unë urrej veten time. Ndjehem sikur nuk jam një qenie njerëzore. Unë nuk mundem më. Miqtë e mi mund të jetojnë një jetë normale unë nuk mundem. Ëndrra ime është të kem një makinë, unë nuk mund të kem atë. Edhe në qoftë se unë kam para për ta blerë atë, ajo kurrë nuk do të jetë e regjistruar në emrin tim. Unë ëndroroj të martohem, por një njeri më shkurajoi, sepse unë nuk kam një shtetësi. Ndjehem si një e burgosur. Dokumentet libaneze janë me më shumë vlerë se ari, ju mund të paguani miliona, por nuk mund ti merni ato. Është kaq e vështirë për mua kur takoj vajza libaneze të cilat kanë shtetësinë dhe dokumentet e tyre, sidomos kur atonuk janë duke përfituar nga privilegji që statusi i tyre u jep –per te studiuar, per te punuar, per te përmbushur ëndrrat që unë dëshiroj të arrija, por që nuk mundem “

Zeynab, një grua pa shtetësi që jeton në Liban

e shtetësisë, të drejtat procedurale, shtetësinë në kuptimin e vazhdimësisë normale të shtetit, detyrimet ushtarake dhe bashkëpunimin ndërmjet Shteteve palë. Ajo gjithashtu përmban shumë dispozita që synojnë parandalimin e krijimit të pashtetësisë. ECN i referohet Konventës së vitit 1954 mbi Statusin e Personave pa Shtetësi për përcaktimin sipas saj të një personi pa shtetësi. Përvoja e kohëve të fundit në Evropë me hyrjen e një varg shtetesh në këtë entitet, çoi në njohjen e faktit se një numër i madh i njerëzish rrezikojnë të mbeten pa shtetësi, sepse ata mund të humbasin shtetësinë e tyre përpara se të fitojnë një tjetër. Në një përpjekje për të shmangur pashtetësinë nëpërmjet hyrjes së një shtetit tjetër - e cila mund të ndodhë si rezultat i transferimit të territorit nga një Shtet në tjetrin, bashkimin e shteteve mes tyre, shpërbërjes së një Shteti, apo ndarjes së një pjese ose të pjesëve të territorit - Këshilli i Evropës miratoi Konventën mbi Shmangjen e Pashtetësisë në raport me Vazhdimësinë e Shteteve. Konventa, e cila u përshtat më 15 mars 2006, përmban rregulla specifike mbi shtetësinë në rastin e mosvazhdimësisë normale së shtetit. 22 nenet e saja ofrojnë udhëzime praktike për çështje të tilla si përgjegjësitë e Shteteve pasardhës dhe paraardhës, rregullat e dëshmisë, shmangjen e pashtetësisë në lindje, dhe lehtësimi për marrjen e shtetësisë nga personat pa shtetësi.

Në vitin 1999 Organizata e Unionit Afrikan (tani Unioni Afrikan) miratoi Kartën Afrikane mbi të Drejtat dhe Mirëqenien e Fëmijës. Karta e modeluar sipas Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës ndan disa parime kyçe me traktatin e mëhershëm, përfshi mos-diskriminimin dhe konsideratën parësore për interesat më të mira të fëmijës. Neni 6 i Kartës, i cili fokusohet tek emri dhe shtetësia dhe që përmban një masë kyçe për të parandaluar pashtetësinë midis fëmijëve, pohon se:

- Çdo fëmijë që në lindje duhet të ketë të drejtën e emrit;
- Çdo fëmijë duhet të regjistrohet menjëherë pas lindjes;
- Çdo fëmijë ka të drejtën e fitimit të një shtetësie;
- Shtetet palë tek Karta duhet të marrin përsipër të sigurojnë që legjislacioni i tyre kushtetues të njohë parimet sipas të cilave një fëmijë duhet të fitojë shtetësinë e shtetit në territorin e Shtetit në të cilin ai ka lindur nëse, në kohën e lindjes së fëmijës, atij nuk i është dhënë shtetësia e ndonjë Shteti tjetër në pajtim me ligjet e tij.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës në Islam u miratua nga Konferenca e 32-të Islamike e Ministrave të Jashtëm në Qershor 2005. Ajo siguron se:

- Çdo fëmijë ka të drejtë që nga lindja për një emër;
- Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i regjistruar;
- Shtetet Palë në këtë Konventë do të bëjnë çdo përpjekje për të zgjidhur çështjen e pashtetësisë për çdo fëmijë të lindur në territoret e tyre ose për ndonjë nga qytetarët e tyre jashtë territorit të tyre; dhe
- Fëmijët e gjetur do të kenë të drejtë për emrin, titullin dhe shtetësinë.

Identifikimi dhe mbrojtja e personave pa shtetësi



Mijëra fëmijë pa shtetësi, migrantë të lindur në Sabah nuk fitojnë shtetësinë e Malajzisë në lindje apo dokumentat e identitetit. Në pamundësi për të hyrë në shkollat Malajziane, ata shpesh përfundojnë duke punuar për pagesë minimale në tregje si ky në Kota Kinabalu. © UNHCR / Greg Konstandini, 2010

Pavarësisht përpjekjeve për reduktimin e shpeshëtësisë së pashtetësisë me anë të ligjeve kombëtare mbi shtetësinë dhe me anë të implementimit të Konventës së vitit 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë dhe instrumente të tjera ndërkombëtare, UNHCR-ja vlerëson se ka miliona njerëz në botë që nuk kanë shtetësi. Konventa e Kombeve të Bashkuara e vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave pa shtetësi përcakton se cili është person pa shtetësi, promovon fitimin e identitetit ligjor për ata persona dhe siguron që personat pa shtetësi të gëzojnë të drejtat dhe liritë themelore pa diskriminim.

Cili konsiderohet person pa shtetësi?

Konventa e vitit 1954 e përcakton një person pa shtetësi si dikush “i cili nuk konsiderohet si shtetas i ndonjë shteti sipas veprimit të ligjit të tij” (neni 1). Ky është një përkufizim krejtësisht ligjor. Ai nuk aludon për të drejtat që gëzojnë shtetasit, mënyrën në të cilën shtetësia është dhënë, apo mundësia për të pasur një shtetësi. Përcaktimi nëse një individ konsiderohet si shtetas sipas veprimit të ligjit të tij kërkon një analizë të kujdesëshme se si një shtet zbaton ligjet e tij kombëtare për shtetësinë si në rastin e një individi në praktikë ashtu edhe çdo vendim për shqyrtim ose apel që mund të ketë pasur ndikim në statusin e individit.

Në përpjekje për të treguar prova të pashtetësisë, Shtetet duhet të rishikojnë legjisllacionin përkatës të shtetësisë së atyre vendeve me të cilat individi ka pasur lidhje të mëparshme (si nëpërmjet lindjes, rezidencës së zakonshme të mëparshme, shteti(et) ku bashkëshorti ose fëmijët janë shtetas, shteti(et) ku prindërit e individit ose gjyshërit janë shtetas), të analizojë informacionin se si korniza ligjore zbatohet në praktikë, përfshi të gjithë informacionet mbi trajtimin e një personi ose popullsie. Nëse është e nevojshme, autoriteti që vendos për statusin këshillohet me ato shtete dhe kërkon prova sipas nevojës. Individët kanë për detyrë të japin një shpjegim të plotë dhe të saktë të pozicionit të tyre dhe të paraqesin të gjitha provat dhe faktet në dispozicion. UNHCR-ja mund të lehtësojë këshillimet midis shteteve dhe mund të japë informacion teknik mbi ligjet relevante dhe implementimin e tyre në Shtete të ndryshme, sipas kërkesës.

Dokumentet nga një autoritet shtetëror përgjegjës që vërtetojnë se individi i interesuar nuk është shtetas janë zakonisht një formë e besueshme e dëshmisë së pashtetësisë. Megjithatë kjo dëshmi mund të mos jetë gjithmonë e gjindshme. Autoritetet përkatëse të vendit të origjinës ose vendit të rezidencës së mëherëshme mund të refuzojnë për të lëshuar dokumente të vërtetuara që

“Ne s’mund të gjejmë punë të rregullt, ne s’mund të lëvizim, ne jemi si varka pa porte. Qasja në arsim dhe kujdes shëndetësor është gjithashtu problem. Unë s’munda të mbaroja shkollën e mesme dhe të shkoja në kolegji. Unë mund ta shoh mjekun vetëm në spital privat, jo në ato shtetërore.”

Abdullah, një beduinë pa shtetësi, që jeton në Emiratet e Bashkuara Arabe

deklarojnë se personi nuk është shtetas, ose ata thjesht mund të mos i përgjigjen kërkesave. Disa autoritete shtetërore do të ndiejnë se ata nuk janë përgjegjës për të përcaktuar se cilët persona nuk kanë lidhje ligjore me vendin. Konkluzione që lidhen me mungesën e përgjigjes duhet të jepen pas një kohe të arsyeshme. Nëse një Shtet ka një politikë të mos reagimit dhe mos prononcimit ndaj këtyre kërkesave, asnjë konkluzion nuk mund të dalë për këtë dështim në përgjigje bazuar vetëm mbi mos dhënien e kësaj përgjigjeje. Në anën tjetër, kur një Shtet në mënyrë rutinore i përgjigjet çështjeve të tilla, mungesa e reagimit do të sjellë në përgjithësi konfirmim të fortë që individi nuk është shtetas.

A mund të përjashtohet një individ nga dispozitat e Konventës së vitit 1954?

Parathënia e Konventës së vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave pa Shtetësi rikonfirmon se refugjatët pa shtetësi mbulohen nga Konventa e 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatit dhe prandaj nuk mbulohen nga Konventa e vitit 1954 në lidhje me personat pa shtetësi.

Përveç përkufizimit të personit pa shtetësi, neni 1 i Konventës së vitit 1954 gjithashtu përfshin ata individë, të cilët pavarësisht se bien brenda kornizave të përkufizimit (d.m.th. pavarësisht faktit se ata janë pa shtetësi) janë megjithatë të përjashtuar nga aplikimi i Konventës për arsye të caktuara, ose sepse ata nuk kanë nevojë për këtë mbrojtje pasi përfitojnë nga skema ligjore specifike apo ndihma ndërkombëtare, ose sepse ata janë të padenjë për mbrojtje ndërkombëtare për shkak të veprimeve të tyre kriminale. Këta persona përfshijnë:

- “ata që aktualisht përfitojnë mbrojtje ose mbështetje e për aq kohë sa ata vazhdojnë ta marrin këtë ndihmë, nga organet ose agjensitë e Kombeve të Bashkuara, përveç Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët.”
- Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Ndihmë dhe Punë për Refugjatët Palestinezë në Lindjen e Afërt është e vetmja agjenci e Kombeve të Bashkuara aktualisht e përshtatshme për këtë masë.
- “ata që janë njohur nga autoritetet kompetente të vendit, ku kanë përfituar leje qëndrimi, se kanë të drejta dhe detyrime të cilat lidhen me marrjen e shtetësisë së atij vendi.”
- Kjo nënkupton që nëse një person pa shtetësi ka siguruar leje qëndrimi të ligjshme në një shtet dhe i janë akorduar të drejta më të mëdha se ato që jepen në bazë të Konventës së vitit 1954, veçanërisht të drejta të plota ekonomike dhe sociale të barabarta me ato që gëzon një shtetas dhe është i mbrojtur nga deportimi dhe përjashtimi, atëherë nuk ka nevojë të aplikohen dispozitat e Konventës mbi atë individ, pavarësisht faktit se ai është pa shtetësi.
- “ata që kanë kryer krime kundër paqes, krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas përkufizimit në instrumentet ndërkombëtare; ata që janë kryer një krim të rëndë jo politik jashtë vendit të tyre të qëndrimit para pranimit në atë vend; ose ata që janë fajtorë për veprime kundër qëllimeve dhe parimeve të Kombeve të Bashkuara.

Kur një person nuk konsiderohet më pa shtetësi?

Kushti i të qenit pa shtetësi merr fund kur individi i interesuar merr/pajiset me një shtetësi.

Sipas një shtese të vitit 1994 në Kushtetutën e Brazilit, fëmijët e lindur jashtë shtetit nga prindër Brazilianë nuk mund të marrin shtetësinë Braziliane nëse ata nuk kthehen për të jetuar në Brazil. Grupet e shoqërisë civile vlerësuan se brenda një dyzinë vitesh, 200.000 fëmijë ishin shndërruar kështu në pa shtetësi. Në vitin 2007, kur Brazili aderoi në Konventën e vitit 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë, Kongresi Kombëtar miratoi një shtesë kushtetuese që zëvendësoi kërkesën e qëndrimit me regjistrimin konsullor si një parakusht për marrjen e shtetësisë. Kjo reformë zbatohet në mënyrë retroaktive, dhe ndihmoi shumë fëmijë pa shtetësi të marrin shtetësinë Braziliane.

Kur është konsiderohet procedurë e vendosjes së statusit pa shtetësi si përgjigja e duhur?

Procedurat e përcaktimit të pashtetësisë në përgjithësi ndihmojnë shtetet në përmbushjen e angazhimeve të tyre sipas Konventës së vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave pa Shtetësi. Ndërsa Konventa e vitit 1954 përkufizon një person pa shtetësi, ajo nuk ka një procedurë të përpunuar për të identifikuar se kush është pa shtetësi. E megjithatë, në Konventën e vitit 1954 thuhet qartë që Shtetet duhet të identifikojnë personat pa shtetësi brenda juridiksionit të tyre në mënyrë që të sigurojnë ata me trajtimin e duhur në përputhje me angazhimet e Konventës.

Përdorimi i procedurave për përcaktimin e pashtetësisë, megjithatë, është vetëm i përshtatshëm për ata persona pa shtetësi të cilët janë në një kuptim migrator. Për personat pa shtetësi të cilët janë në "vendin e tyre" ose popullatat në vend *in situ*, procedurat e përcaktimit për qëllimin e marrjes së statusit të personave pa shtetësi nuk janë të përshtatshme për shkak të lidhjeve të tyre të forta, të tilla si qëndrimit afatgjatë të përhershëm, në këto vende. Duke u varur nga rrethanat e popullsisë në shqyrtim, Shtetet janë të këshilluara që të ndërmarrin fushata që kanë në fokusin e tyre shtetësinë ose përpjekje për verifikimin e shtetësisë në vend që të përdorin procedurat e pashtetësisë lidhur me këto popullsi.

Cilat janë procedurat e përdorura për të përcaktuar nëse një person është pa shtetësi?

Vetëm një numër i vogël i shteteve kanë krijuar procedura të specializuara për të ndërmarrë përcaktimin e statusit të pashtetësisë. Megjithatë, ka një interes në rritje në mesin e shteteve për të vendosur procedura të tilla. Se ku duhen vendosur procedurat për përcaktimin e pashtetësisë institucionalisht është një çështje e gjykimit të Shteteve dhe mund të ndryshojë nga shteti në shtet. Pavarësisht se ku janë të vendosura brenda kornizës ligjore ose administrative të një Shteti procedurat e përcaktimit të pashtetësisë, është e rëndësishme që analistët të zhvillojnë ekspertiza të përcaktimit të pashtetësisë duke siguruar se procedurat janë në dispozicion të popullsisë në fjalë. Kjo kërkon një ekuilibër mes ekspertizës së përqendruar për të kryer përcaktimin e pashtetësisë brenda një njësie të specializuar administrative apo gjyqësore me zyrtarë të trajnuar dhe me përvojë, duke u lejuar individëve për të paraqitur aplikimet tek përfaqësues të qeverisë të cilët mund të jenë të shpërndarë në të gjithë vendin. Disa shtete e kanë miratuar zbatimin e legjisllacionit që përcakton agjencitë specifike brenda qeverisë - zyra që merren në mënyrë specifike me azilin, refugjatët dhe personat pa shtetësi, ose Ministrinë e Brendshme, për shembull - që do të shqyrtojnë dhe të gjykojnë pretendimet e pashtetësisë.

Shtete të tjera që nuk kanë legjislacion specifik që krijon një procedurë për njohjen e pashtetësisë kanë institucionalizuar një autoritet administrativ ose gjyqësor që është i ngarkuar me përcaktimin nëse një individ është pa shtetësi.

Shumë shtete, megjithatë, nuk kanë procedurë të veçantë në vend. Në shumë prej këtyre rasteve, çështja e pashtetësisë shpesh lind gjatë procedurave për përcaktimin e statusit të refugjatit. Personat pa shtetësi mund pastaj të "përpunohen" në këtë kuadër, që përfshin mbrojtjen humanitare ose plotësuese. Personat pa shtetësi mund, në fakt, të jenë të detyruar që të kanalizojnë aplikimet e tyre nëpërmjet regjimit të azilit, thjesht sepse nuk ka procedurë tjetër në dispozicion të tyre. Kërkesat e konfidencialitetit për aplikimet nga azil-kërkuesit duhet të respektohen pavarësisht nga forma ose vendndodhja e procedurës për përcaktimin e pashtetësisë.

Disa vende nuk kanë procedurë specifike të njohjes për personat pa shtetësi, por çështja mund të lindë kur një individ aplikon për një leje qëndrimi ose dokument udhëtimi, ose në qoftë se një aplikim për azil refuzohet dhe një kërkesë është bërë për të qëndruar në një vend azili bazuar në arsye të tjera.

Në Francë, procedura për njohjen e statusit pa shtetësi është kryer në kuadër të Zyrës Franceze për Mbrojtjen e Refugjatëve dhe Personave pa shtetësi (OFPPA), e cila është e mandataruar për të siguruar mbrojtje gjyqësore dhe administrative ndaj personave pa shtetësi. Aplikantët duhet të aplikojnë direkt në OFPPA.

Në Filipine, përcaktimi i Pashtetësisë është ndërmarrë nga Njësia e centralizuar për Mbrojtjen e Refugjatëve dhe Personave pa shtetësi (RSPPU), e cila është administruar nga Departamenti i Drejtësisë në Filipine. Aplikimet për statusin e pashtetësisë mund të dorëzohen në RSPPU ose në ndonjë zyrë qendrore ose në zyrat e Byrosë së Emigracionit në terren.

Në Republikën e Moldavisë, Zyra për Migracionin dhe Azilin e Ministrisë së Punëve të Brendshme kryen procedura administrative të centralizuara të përcaktimit të pashtetësisë. Aplikimet mund të dorëzohen me gojë ose me shkrim dhe mund të nxiten nga individë të interesuar apo nga një njësi e specializuar administrative në kuadër të Byrosë Moldave për Migracionin dhe Azilin.

Në Spanjë, Ligji për të Huajt parashikon që Ministria e Brendshme do të njohë statusin e pashtetësisë në një procedurë të rregulluar me Dekretin Mbretëror. Aplikantët mund të paraqiten në stacionet policore ose në Zyrën për Azilin dhe Refugjatët (OAR). Pas përfundimit të fazës hetimore, OAR zhvillon procedura pastaj përcjell vlerësimin e saj të arsyetuar në Ministrinë e Brendshme.

Edhe pse Meksika nuk ka themeluar një procedurë formale të përcaktimit të pashtetësisë, Manuali i saj i kriterëve migratore dhe Procedurave i vitit 2010 parashikon që personat pa shtetësi mund të marrin mbrojtje ndërkombëtare përmes sistemit Meksikan të mbrojtjes plotësuese. Ndërkohë që manuali ofron një përkufizim të asaj që e kthen një person pa shtetësi, ai nuk përcakton asnjë procedurë për përcaktimin e statusit në raste individuale.

Doracaku i UNHCR-së për Mbrojtjen e Personave pa Shtetësi ofron udhëzime për qeveritë, personelin e UNHCR-së dhe aktorë të tjerë në lidhje me modalitetet e krijimit të procedurave për përcaktimin e pashtetësisë, duke përfshirë edhe çështjet e dëshmimeve të cilat lindin në procedurat e tilla.

Çfarë dëshmie nevojitet?

Duke pasur parasysh natyrën e pashtetësisë, individët e kanë shpesh të pamundur për të mbështetur një kërkesë për statusin e pashtetësisë me prova të dokumentuara dhe bindëse, gjithmonë nëse kanë të tilla. Shumë individë nuk janë në dijeni të nevojës, ose nuk janë në gjendje për të kryer shqyrtimet e nevojshme të ligjeve të shtetësisë së vendeve me të cilat ato kanë lidhje nëpërmjet lindjes, prejardhjes, martesës ose vendbanimit të zakonshëm. Përveç kësaj, kontakti me autoritetet e huaja për të kërkuar informacion specifik në lidhje me rastin e një individ apo udhëzime të përgjithshme mbi ligjet e shtetësisë së një vendi, duke përfshirë edhe sqarime si në ligj ashtu edhe në zbatim, mund të jetë themelor në rezultime një konkluzion nëse një individ është pa shtetësi ose jo. Në shumë raste, shtetet do t'u përgjigjen pyetjeve të tilla, vetëm kur ato të jenë të nisura nga zyrtarët e qeverisë së një Shteti tjetër.

Procedurat e përcaktimit të pashtetësisë duhet pra të marrin parasysh vështirësitë e të provuarit të pashtetësisë. Procedurat e përcaktimit të pashtetësisë kërkojnë që të dy palët, aplikanti dhe shqyrtuesi të bashkëpunojnë për të marrë prova dhe të vërtetojnë faktet - kjo është përmendur si ndarje e barrës së provës. Për shkak të vështirësive të qenësishme për të provuar pashtetësinë, pragu i provave të nevojshme para se pashtetësia të përcaktohet nuk duhet të jetë shumë e lartë. Prandaj Shtetet janë të këshilluara që të miratojnë të njëjtin standard të provës si ai që kërkohet në përcaktimin e statusit të refugjatëve, pra, që një gjetje e pashtetësisë të jetë e garantuar kur krijohet për të "një shkallë e arsyeshme" se individ nuk konsiderohet si shtetas i ndonjë shteti tjetër sipas veprimit të ligjit të tij. Doracak i UNHCR-së për Mbrojtjen e Personave pa Shtetësi jep udhëzime të mëtejshme se si barra dhe standardi i provës duhet të zbatohen në procedurat e përcaktimit të pa shtetësisë.

Kush duhet të vendosë nëse një individ është pa shtetësi?

Personel i kualifikuar, që është i specializuar në fushën e pashtetësisë dhe që në mënyrë të paanshme dhe objektive mund të shqyrtojë aplikimin dhe dëshmitë mbështetëse, duhet të caktohet për të marrë vendimet për statusin. Një autoritet qendror përgjegjës për këto vendime do të zvogëlonte rrezikun e vendimeve konfliktuale, do të ishte më efektiv në marrjen dhe shpërndarjen e informacionit tek vendet e origjinës dhe për shkak të punës së tij të fokusuar, do të ishte më mirë në gjendje të zhvillonte ekspertizën e tij për çështjet që lidhen me pashtetësinë. Vendimi për statusin e pashtetësisë kërkon mbledhjen dhe analizën e ligjeve, rregulloreve dhe praktikave të shteteve të tjera. Edhe pa një autoritet qendror, vendim-marrësit përfitojnë nga bashkëpunimi me kolegët që kanë dijeni për legjislacionin mbi shtetësinë dhe çështjen e pashtetësisë si brenda qeverisë ashtu edhe në shtetet e tjera.

Si përfitojnë individët mundësi për procedurë?

Konventa e vitit 1954 lidhur me Statusin e Personave Pa Shtetësi nuk i detyron shtetet që ti japin qëndrim ligjor një individ, ndërkohë që kërkesa e tij për njohjen si një person pa shtetësi është duke u vlerësuar. Praktikisht, kur një individ është në territorin e një Shteti, një përcaktim i statusit të tij të shtetësisë mund të jetë e vetmja mënyrë për të identifikuar një zgjidhje për gjendjen e tij.

Kur një individ ka bërë një kërkesë për t'u njohur si pa shtetësi, ose në qoftë se autoritetet janë duke u përpjekur për të përcaktuar se nëse apo jo një individ është pa shtetësi,

Shtetet janë të këshilluara që të pezullojnë largimin e këtyre personave nga territoret e tyre në pritje të rezultatisë të procesit të përcaktimit të statusit të tyre.

Procedurat e përcaktimit të pashtetësisë duhet të formalizohen në ligj, duke siguruar drejtësi dhe transparencë. Doracaku i UNHCR-së për *Mbrojtjen e Personave pa Shtetësi* ofron një listë të plotë të së drejtave të procesit që duhet të respektohen, duke përfshirë:

- qasje në një intervistë;
- ndihmë në përkthim;
- qasje në ndihmë dhe këshillim juridik;
- afatet brenda të cilit përcaktohet pashtetësia duhet të bëhen nga koha kur një kërkesë është paraqitur;
- të drejtën për të marrë me shkrim arsyet për një vendim; dhe
- të drejtën për të kundërshtuar refuzimin e shkallës së parë të aplikimit.

A mundet një shtet të ndalojë një person pa shtetësi që nuk ka qëndrim të ligjshëm?

Edhe pse Konventa e vitit 1954 nuk u kërkon shteteve në mënyrë të drejtpërdrejtë e të qartë që ti japin të drejtën e banimit një personi të përcaktuar si pa shtetësi, dhënia e një leje të tillë do të përmbushë objektin dhe qëllimin e traktatit. Personat pa shtetësi të cilët nuk kanë të drejtë për të qëndruar ligjërisht në një vend nuk duhet normalisht të arrestohen. Individët që janë pa shtetësi shpesh nuk kanë dokumente identifikimi, të tilla si kartat kombëtare të identitetit apo pasaportat. Edhe në qoftë se vendi i mëparshëm i vendbanimit është identifikuar, shpesh ai vend nuk do të pranojë menjëherë ripanimin e individit. Në këto situata, ndalimi duhet të shmanget dhe vetëm të trajtohet në mënyrë të qartë, nëse bazohet në legjislacionin kombëtar që përputhet me të drejtën ndërkombëtare të së drejtave të njeriut. Alternativat për paraburgim duhet të hulumtohen më parë, deri në momentin që ka prova për të sugjeruar se alternativat nuk do të jenë të zbatueshme për individët e interesuar.

Personat pa shtetësi pa një qëndrim ligjor duhet të ndalohen vetëm pasi të merren parasysh të gjitha alternativat e mundshme. Në marrjen e vendimeve të jashtëzakonshme për të ndaluar dikë, autoritetet duhet të përcaktojnë nëse ndalimi është i arsyeshëm dhe proporcional me objektivat që duhet të arrihen. Nëse gjykohet e nevojshme, paraburgimi duhet të zbatohet vetëm në mënyrë jo-diskriminuese, të jetë i përshtatur me ligjin e vendit, mundësisht me kufinj maksimalë të vendosur mbi këtë paraburgim dhe të jetë subjekt i rishikimit periodik dhe gjyqësor.

Grupi i Punës mbi Ndalimin Arbitrar

Komisioni për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara ka trajtuar shtimin shqetësues të rasteve të ndalimit arbitrar që nga viti 1985. Ai i ka kërkuar Nën-Komisionit për Parandalimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjes së Minoriteteve të ndërmarë një studim të hollësishtëm për këtë çështje dhe të dorëzojë rekomandime tek ai për zvogëlimin e praktikave të tilla. Në të njëjtën kohë, shqetësimi për garancitë që duhet të bëjnë të gjithë njerëzit të privuar nga liria e tyre, u manifestua me miratimin nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, në dhjetor 1988, të Tërësisë së Parimeve për Mbrojtjen e të gjithë Personave

nën çdo lloj Forme Ndalimi ose Burgosjeje. Në vitin 1990, në vijim të rekomandimeve të bëra në raportin e sipërpërmendur të Nënkomisionit, Komisioni për të Drejtat e Njeriut ngriti Grupin e Punës mbi Ndalimin Arbitrar. Grupi i Punës më vonë miratoi parimet e mëposhtme që rregullojnë izolimin dhe ndalimin:

Parimi 1

Një azilkërkues ose emigrant, kur mbahet për pyetje në kufi ose brenda territorit shtetëror në rast të hyrjes së paligjshme, duhet të informohet të paktën verbalisht, dhe në gjuhën të cilën ai ose ajo kupton, për natyrën dhe bazën e vendimit për refuzimin e hyrjes në kufi ose të lejes për qëndrim të përkohshëm në territor, që është duke u shqyrtuar në lidhje me personin në fjalë.

Parimi 2

Një azilkërkues ose imigrant duhet të ketë mundësinë, ndërsa mbahet në izolim, të komunikojë me botën e jashtme, përfshi me anë të telefonit, faksit, postës elektronike dhe të kontaktojë me një avokat, përfaqësues konsullor dhe të afërmit.

Parimi 3

Një azilkërkues ose emigrant i vendosur në izolim duhet të sillet menjëherë para një autoriteti gjyqësor apo një autoriteti tjetër.

Parimi 4

Një azilkërkues ose imigrant, kur vendoset në izolim duhet të japë nënshkrimin e tij/e saj në regjistrin që është i numëruar dhe i lidhur, ose që jep garanci të barazvlefshme, duke treguar identitetin e personit, bazën për izolimin dhe autoritetin kompetent, i cili ka vendosur për masën si dhe për kohën dhe datën e pranimit në izolim dhe të lirit prej tij.

Parimi 5

Një azilkërkues ose imigrant sapo pranohet në një qendër izolimi duhet të informohet për rregullat e brendshme dhe kur është e përshtatshme për rregullat e aplikueshme disiplinore, për çdo mundësi për t'u mbajtur i izoluar nga të tjerët si dhe për garancitë që shoqërojnë këtë masë.

Parimi 6

Vendimi duhet të merret nga një autoritet i ngarkuar me pushtet sipas rregullave me një nivel të mjaftueshëm përgjegjësie dhe duhet të bazohet në kriterin e ligjshmërisë së rregulluar me ligj.

Parimi 7

Një periudhë maksimale duhet të caktohet me ligj dhe izolimi në asnjë rast nuk mund të jetë për një periudhë pa afat apo me kohëzgjatje të madhe.

Parimi 8

Njoftimi për masat e izolimit duhet të jepet me shkrim, në një gjuhë që kuptohet nga azilkërkuesi ose imigranti, duke treguar bazën për këtë masë; ai duhet të vendosë

kushtet sipas së cilave azilkërkuesi ose imigranti duhet të jetë në gjendje të aplikojë për korrigjim tek një autoritet gjyqësor, i cili duhet të vendosë menjëherë për ligjshmërinë e masës dhe kur është e përshtatshme, të urdhërojë lirimin e personit në fjalë.

Parimi 9

Izolimi duhet të kryhet në një godinë publike, të përcaktuar me qëllim për këtë arsye; kur, për arsye praktike kjo nuk është e mundur, azilkërkuesi ose emigranti duhet të vendoset në një ambient të veçantë nga ai i personave të burgosur në bazë të ligjeve penale.

Parimi 10

Zyra e Komisionerit të Lartë për Refugjatët (UNHCR), Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) dhe, kur është e mundur, organizatat joqeveritare të autorizuara sipas rregullave, duhet të lejohen të hyjnë në vendet e izolimit.

Cilat janë të drejtat dhe detyrimet e personave që njihen pa shtetësi?

Ka disa të drejta themelore që zbatohen për të gjithë personat, pavarësisht statusit të tyre ose llojit të qëndrimit në një juridiksion të caktuar. Këto përfshijnë për shembull ndalimin e torturës dhe parimin e mos diskriminimit. Në të vërtetë Konventa e vitit 1954 lidhur me Statusin e Personave Pa Shtetësi pohon se dispozitat e saj aplikohen tek personat pa shtetësi “pa diskriminim race, besimi apo vendi të origjinës” (Neni 3).

Çdo person pa shtetësi ka detyrimin të respektojë ligjet dhe rregulloret e vendit ku ai gjendet (Neni 2). Duke supozuar që ky detyrim është plotësuar, neni 7 (1) i Konventës së vitit 1954 parashtron nivelin bazë të mbrojtjes që i takon çdo personi pa shtetësi. Ai parasheh se, përveç rasteve kur Konventa shprehimisht përmban një trajtim më të favorshëm, “Shteti kontraktues duhet t’u japë personave pa shtetësi të njëjtin trajtim që u jepet të huajve në përgjithësi”.

Në lidhje me shumicën e të drejtave të renditura në Konventën e vitit 1954, personat pa shtetësi duhet të kenë të paktën të njëjtin mundësi për të drejta dhe përfitime si ato që u garantohen të huajve, veçanërisht në lidhje me fitimin e punësimit (neni 17, 18 dhe 19), strehimin (neni 21) dhe lirinë e lëvizjes (neni 26). Për të drejta të tjera specifike, Shtetet Kontraktuese janë të inkurajuar t’u japin personave pa shtetësi që banojnë në mënyrë të ligjshme në territorin e tyre një trajtim standard të krahasueshëm me atë që u jepet shtetasve të shtetit, sidomos liria për të praktikuar besimin fetar (neni 4), të drejtat artistike dhe të pasurisë industriale (neni 14), edukimin elementar (neni 22), qasja në gjykata (neni 16), ndihma publike (neni 23) dhe legjislacioni i punës dhe sigurimi social (nenin 24).

Doracaku i UNHCR-së për mbrojtjen e personave pa shtetësi ka për qëllim të ndihmojë qeveritë për të siguruar që personat pa shtetësi të gëzojnë standartin e trajtimit të kërkuar sipas Konventës së vitit 1954 dhe të Drejtës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.

A gëzojnë personat që njihen si pa shtetësi të drejtën e identitetit dhe dokumenteve zyrtare?

Konventa e vitit 1954 parasheh që Shtetet Kontraktuese të lëshojnë dokumente identiteti tek çdo person pa shtetësi në territorin e tyre, i cili nuk posedon një dokument të vlefshëm udhëtimi. Neni 28 parasheh që palët kontraktuese duhet të lëshojnë dokumente udhëtimi

tek personat pa shtetësi që banojnë në mënyrë të ligjshme në territorin e tyre, përveç nëse arsye mbizotëruese të sigurisë kombëtare dhe rendit publik kërkojnë të kundërtën.

Lëshimi i një dokumenti udhëtimi nuk përfshin dhënien e shtetësisë dhe nuk ndryshon statusin e individit.

Pjesa e dytë e nenit 28 i fton shtetet të lëshojnë dokumente udhëtimi tek çdo person pa shtetësi në territorin e tyre, edhe tek ata që nuk janë rezidentë të ligjshëm. Shteteve u kërkohet të shqyrtojnë lëshimin e Dokumenteve të Udhëtimit sipas Konventës tek personat pa shtetësi që janë në territorin e tyre dhe që nuk janë në gjendje të përfitojnë një dokument udhëtimi nga vendi i tyre i rezidencës së ligjshme. Kjo dispozitë është veçanërisht e rëndësishme duke qenë se shumë persona pa shtetësi mund të mos kenë një vend të rezidencës së ligjshme. Një dokument udhëtimi ndihmon si në identifikimin e personit pa shtetësi, por edhe i lejon individit të kërkojë hyrje në një vend të përshtatshëm për të.

Dokumentet e udhëtimit janë veçanërisht të rëndësishme për personat pa shtetësi për lehtësimin e udhëtimit në vende të tjera për studim, punësim, kujdes shëndetësor ose rivendosje në një vend. Në pajtim me Programin e Konventës, çdo shtet kontraktues bie dakord të njohë vlefshmërinë e dokumenteve të udhëtimit të lëshuara nga shtetet e tjera palë. UNHCR mund të ofrojë ndihmë teknike në lëshimin e këtyre lloj dokumentesh. Shteteve palë në Konventën e vitit 1954 u kërkohet tu lëshojnë dokumenta udhëtimi, të prodhuar në makineri të posacme dhe të lexueshme, personave pa shtetësi, në përputhje me standartet dhe përcaktimet e vendosura në Guidën e UNHCR-së/Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil për Lëshimin e Dokumentave të Konventës të Printuar dhe të Lexueshëm për Refugjatë dhe Persona Pa Shtetësi.

A mundet një shtet të përzërë një person që njihet si pa shtetësi?

Sipas kushteve të Konventës së vitit 1954, personat pa shtetësi që qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në vend nuk mund të përzihen, përveç mbi baza të sigurisë kombëtare dhe rendit publik. Përzëniet i nënshtrohen garancive të procesit të duhur ligjor, përveç nëse ka arsye mbizotëruese të sigurisë kombëtare. Pra garancitë procedurale duhet të jenë në vend për t'u lejuar personave pa shtetësi të përgjigjen dhe dorëzojnë dëshmi në lidhje me çdo akuzë, për t'u përfaqësuar nga një mbrojtës ligjor dhe për t'iu dhënë e drejta e ankimit.

Akti Final i Konventës së vitit 1954 tregon se moskthimi është një parim i pranuar gjerësisht. "Moskthimi", që është parimi i moskthimit të një personi në një territor ku ai/ajo do të ishin në rrezik nga persekutimi, është i mbështetur shprehimisht ose i interpretuar në dispozitat e disa traktateve ndërkombëtare, përfshi nenin 33 të Konventës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve, neni 3 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese, dhe neni 7 i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe disa instrumente rajonale mbi të drejtat e njeriut.

Duke qenë se ndalimi i kthimit është pranuar si parim i të drejtës ndërkombëtare hartuesit e Konventës së vitit 1954 menduan se ishte e nevojshme ta përfshinin atë në nenet e Konventës që rregullon statusin e personave pa shtetësi "de jure".

Sapo merret një vendim përfundimtar për dëbimin, Konventa e vitit 1954 lidhur me Statusin e Personave Pa Shtetësi u kërkon shteteve t'i japin individit në fjalë kohë të mjaftueshme për të siguruar pranimin në një vend tjetër.

Çfarë lloj procedure e natyralizimit duhet të jetë në dispozicion të personave të njohur si pa shtetësi?

Shteteve palë në Konventën e vitit 1954 u kërkohet të lehtësojnë asimilimin dhe natyralizimin e personave pa shtetësi në masën më të madhe të mundshme. (Fjala “asimilim” këtu nuk nënkupton humbjen e identitetit specifik të personave të përfshirë, por më shumë integrimin e tyre në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit.) Në veçanti atyre u kërkohet të bëjnë çdo përpjekje për të përshpejtuar procedurat e natyralizimit, përfshi zvogëlimin e tarifave dhe kostove kurdo që kjo është e mundur.

Në Mbretërinë e Bashkuar, personat pa shtetësi mund të hyjnë në procedura të lehtësuara të natyralizimit. Praktikisht, kjo do të thotë një kërkesë më e reduktuar e qëndrimit (tre vjet në krahasim me pesë vjet për të huajt me shtetësi) dhe një përjashtim nga testet e gjuhës dhe të shtetësisë.

Disa vende kanë përfshirë në legjislacionet e tyre të shtetësisë kushte të kufizuara të leje q ëndrimit së ligjshme për refugjatët dhe personat pa shtetësi që dëshirojnë të aplikojnë për natyralizim.

Konventa Evropiane mbi Shtetësinë e 1997 (ECN) e zhvillon më tej këtë rekomandim duke kërkuar që e drejta e brendshme të përmbajë rregulla që e bëjnë të mundshme për të huajt rezidentë të ligjshëm dhe tradicional në territor për t'u natyralizuar. ECN më tej kufizon çdo kërkesë për rezidencë tek një maksimum prej 10 vitesh para se një individ të jetë në gjendje të parashtrojë një aplikim për natyralizim. Konventa gjithashtu inkurajon shtetet të shqyrtojnë përdorimin procedurave të përshpejtuara të natyralizimit për personat pa shtetësi dhe të njohur si refugjatë.

Cilat janë mënyrat më të mira për mbrojtjen e personave pa shtetësi?

Mënyra më efektive për mbrojtjen e personave pa shtetësi është me anë të përpilimit të legjislacionit që si fillim e bën të pamundur krijimin e situatës të pashtetësisë (shih Kapitullin Parandalimi I Pashtetësisë për një diskutim të plotë të Konventës së vitit 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë dhe të masave të ndërlydhura që shtetet mund të miratojnë për reduktimin dhe eliminimin e pashtetësisë).

Megjithatë derisa të eliminohet problemi i pashtetësisë, personat që njihen si pa shtetësi duhet të mbrohen. Aderimi dhe zbatimi i Konventës së vitit 1954 dhe miratimi i legjislacionit zbatues do të sigurojë respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të personave pa shtetësi.

Siç u përmend më lart Konventa e vitit 1954 për Statusin e Personave Pa Shtetësi nuk e ndryshon shtetësinë e një individit, as nuk i detyron shtetet të pranojnë personat jo refugjatë pa shtetësi në territorin e tyre. Aplikimi i dispozitave të Konventës së vitit 1954 nuk është një zëvendësim për dhënien e shtetësisë. Kurdo që është e mundur shtetet duhet të lehtësojnë asimilimin dhe natyralizimin e personave pa shtetësi që jetojnë në territorin e tyre me anë të legjislacionit dhe praktikës së shtetësisë. Për situata masive të rasteve të pashtetësisë, rregullat për delegimin e shtetësisë mund të ndryshohen duke i konsideruar të gjithë personat rezident në territor si shtetas duke qenë se ata kanë lindur në këtë territor (ose kanë jetuar aty) përpara një date të caktuar, ose janë pasardhës të këtyre personave.

Kirgistani miratoi reforma të gjithanshme në vitin 2007, të cilat mundësuan që mijëra njerëz pa shtetësi të merrnin shtetësinë. Rreth 40,000 persona kishin jetuar në Kirgistan pa shtetësi për më shumë se një dhjet ëvjeçar pas pavarësisë, pjesa e madhe e tyre pakica etnike të ardhura nga pjesë të tjera të ish-Bashkimit Sovjetik, dhe nuk e fituan automatikisht shtetësinë e Kirgistanit ose shtetësinë në ndonjë shtet tjetër pasardhës të ish-Bashkimit Sovjetik. Ligji i vitit 2007 njohu si shtetas të gjithë ata shtetas e ish-Bashkimit Sovjetik që ishin pa shtetësi dhe që ishin banuar në Kirgistan për pesë ose më shumë vite.

Në disa raste përjashtimore, mund të mos jetë e mundur për personat pa shtetësi që të normalizojnë statusin e tyre ligjor në vendin ku jetojnë. Pra rivendosja në një vend tjetër mund të jetë zgjidhja e përshtatshme për këta individë. Ndërsa kriteri i shteteve për rivendosjen në një vend të tretë zakonisht nuk mbulon situatat e pashtetësisë (rivendosja më shpesh përdoret për refugjatët), Komiteti Ekzekutiv i UNHCR-së së fundmi u ka bërë thirrje shteteve ta zgjerojnë kriteret e tyre për të përfshirë personat pa shtetësi. Në Konkluzionin e tij Nr. 95 (2003), Excom:

"I inkurajonte shtetet (e Excom-it) për të bashkëpunuar me UNHCR-në mbi metodat për zgjidhjen e rasteve të pashtetësisë dhe për të shqyrtuar mundësinë e ofrimit të vendeve të rivendosjes kur situata e një personi pa shtetësi nuk mund të zgjidhet në vendin aktual pritës ose në vendin e rezidencës së mëparshme të zakonshme, dhe mbetet e pasigurt

UNHCR-ja mund të ofrojë këshillim dhe ndihmë tek shtetet si për integrimin dhe për rivendosjen e personave pa shtetësi.

Parandalimi i pashtetësisë



Pjesa më e madhe e fëmijëve në këtë batej (një qytezë e ngritur në periferi qyteti) janë pa shtetësi dhe nuk kanë mundësi të gëzojnë të drejtat më themelore. Mijëra Domenikanë, më së shumti të origjinës Haitiane, u privuan nga shtetësia e tyre me miratimin e Rregullores së re Kushtetuese Gjyqësore të vitit 2013

©UNHCR/Greg Constantine, 2011

Pashtëtësia mund të vijë si rezultat i një sërë arsyesh e kushtesh të ndryshme. Disa prej shumë shkaqeve që rezultojnë në pashtetësi dhe hapave konkretë praktikë që Shtetet duhet të ndërmarrin për të shmangur këto kushte, në veçanti kur shqyrtohen kuadret ligjore kombëtare në lidhje me shtetësinë, diskutohen në paragrafët që vijojnë.

Shkaqet e lidhura me diskriminimin ose privimin arbitrar të shtetësisë

Diskriminimi

Një prej kufizimeve kryesore në qëndrimin e pavarur të shtetit për të dhënë ose mohuar shtetësinë është ndalimi ndaj diskriminimit racial. Ky parim është reflektuar në Konventën mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial dhe në shumë instrumente të tjera. Në Rekomandimin e Përgjithshëm mbi Diskriminimin kundër Jo Qytetarëve të 1 tetorit 2004, Komiteti i Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e Diskriminimit Racial thekson se:

“privimi i shtetësisë në bazë të racës, ngjyrës, trashëgimisë, ose origjinës kombëtare ose etnike është cenim i detyrimeve të shtetit për siguruar gëzimin në mënyrë jo diskriminuese të së drejtës së shtetësisë.”

Megjithatë shpesh herë individët nuk janë në gjendje për të fituar shtetësinë e një shteti të caktuar pavarësisht lidhjeve të forta me atë shtet - lidhje që për persona të tjerë, do të ishin të mjaftueshme për të nxitur dhënien e shtetësisë. Diskriminimi bazuar në përkatësinë e racës, ngjyrës, etnisë, besimit fetar, gjinisë, opinionit politik ose faktorëve të tjerë mund të jetë ose i hapur ose i krijuar pa qëllim në ligje ose si pasojë, në zbatueshmërinë e këtyre të fundit. Mund të konsiderohet se ligjet janë diskriminuese nëse ato anë në përmbajtje të tyre gjuhë parajgykuese ose nëse rezultati i aplikimit të tyre është diskriminimi.

Për të shmangur këtë problem:

- Të sigurohet që parimi i mos diskriminimit në lidhje me shtetësinë të përfshihet në kushtetutë dhe në ligjet që lidhen me shtetësinë, dhe të sigurohet me anë të vendimeve administrative dhe gjyqësore zbatimi efikas i këtij i parimit.
- T’iu kërkohet shteteve të miratojnë çdo masë të nevojshme, qoftë së brendshmi dhe në bashkëpunim me shtetet e tjera, për të siguruar që çdo fëmijë të ketë një shtetësi kur ai/ajo të lindë. Pra fëmijët e lindur nga prindër të martuar, fëmijët e lindur jashtë martesë dhe fëmijët e lindur nga prindër pa shtetësi të kenë të gjithë të drejtë të barabartë në shtetësi sipas të drejtës ndërkombëtare.
- Konventa e 1979 mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave kërkon t’u jepet grave të drejta të barabarta me burrat për fitimin, ndryshimin ose mbajtjen e shtetësisë. Në pajtim me parimet e kësaj Konvente, statusi i shtetësisë së bashkëshortit nuk duhet të ndryshojë automatikisht shtetësinë e bashkëshortes, ta lërë atë pa shtetësi, apo ta bëjë të detyrueshme marrjen prej saj të shtetësisë së tij.

Privimi dhe mohimi i shtetësisë

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) parasheh se asnjë nuk duhet të privohet arbitrarisht nga shtetësia. Konventa e 1961 dhe Konventa Evropiane e 1997 mbi Shtetësinë kufizojnë ngushtë mundësitë e shteteve për të iniciuar humbjen e shtetësisë. Çdo humbje e shtetësisë duhet të shoqërohet nga garanci të plota procedurale dhe nuk duhet të rezultojë në pashtetësi. Heqja e shtetësisë ndodh kur një shtet e privon një individ nga shtetësia, zakonisht sepse shteti është i përfshirë në praktika diskriminuese. Pjesa dërmuese e personave pa shtetësi në mbarë botën gjenden në këtë situatë për shkak të privimit arbitrat ndaj shtetësisë së tyre.

Për të shmangur këto probleme:

- Parimi bazë i të drejtës ndërkombëtare është që asnjë individ nuk duhet të privohet nga shtetësia, nëse ky privim rezulton në pashtetësi.
- Konventa e 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë bën përjashtimet e mëposhtme nga ky parim:
- Shtetësia e fituar nga keq përfaqësimi ose mashtrimi për të;
- Humbja e shtetësisë që pason banimin jashtë vendit (shih më lart);
- Aktet e papajtueshme me detyrimin e besnikërisë, si në cënimin e një ndalimi të shprehur për t'i dhënë shërbime një vendi tjetër, ose me anë të sjelljes personale seriozisht paragjyquese për interesat jetësore të shtetit (vetëm nëse janë të specifikuar në ligj në kohën e nënshkrimit të Konventës); ose
- Betimi ose deklarata formale e besnikërisë tek një shtet tjetër ose hedhja poshtë e besnikërisë ndaj shtetit (vetëm nëse specifikohet në ligj në kohën e nënshkrimit të Konventës së 1961 Mbi Reduktimin e Pashtetësisë).

Në vitin 1980, Kurdët nga Faili, më së shumti një minoritet shiit qëjetonin në disa province të Irakut, u privuan dhe ju hoq shtetësia e tyre Irakene me anë të një dekreti të lëshuar asokohe nga Sadam Hussein. Pronat e tyre u konfiskuan dhe shumë prej tyre u deportuan në Iran, ku ata jetuan në kampe si refugjatë. Kushtetuta e Irakut e vitit 2005 dhe Akti Iraken mbi Shtetësinë i vitit 2006 shfuqizuan dekretin e mëparshëm i cili ju kishte hequr shtetësinë Kurdëve Faili, duke përcaktuar se për të gjithë individët të cilëve ju ishte hequr shtetësia Irakene nga Qeveria pararendëse mund të ri-kërkonin e merrnin atë. Që prej asaj kohe rreth 100,000 individë kanë ri-marrë shtetësinë e tyre Irakene.

Shteti palë i Konventës së 1961 mund ta privojë në individ nga shtetësia e tij vetëm mbi shkaqet e mësipërme, nëse janë të treguara specifikisht në ligj në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, ose aderimit dhe nëse janë në pajtim me ligjin dhe të shoqëruara nga garanci të plota procedurale, si e drejta e dëgjimit të drejtë. Shteti kontraktues nuk mund të privojë asnjë person ose grup personash nga shtetësia e tyre mbi baza raciale, etnike, fetare ose politike.

- Konventa Evropiane e 1997 mbi Shtetësinë kufizon edhe më tej kapacitetin e shteteve për të privuar personat nga shtetësia e tyre, nëse kjo rezulton me pashtetësinë. Sipas kësaj Konvente, privimi i shtetësisë justifikohet vetëm në

raste të fitimit të shtetësisë me mashtrim, ose keq përfaqësim. Megjithatë nëse privimi i shtetësisë nuk rezulton në fund me pashtetësi, shteti mund ta privojë një shtetas nga shtetësia e tij për shkaqe të:

- Fitimit vullnetar të shtetësisë tjetër;
- Shërbimit vullnetar në forcën ushtarake të huaj;
- Sjelljes serioze paragjyquese për interesat jetësore të shtetit;
- Mungesës së lidhjes së qartë mes shtetit dhe shtetasit, i cili banon zakonisht jashtë;
- Parakushteve që çojnë tek fitimi automatik i shtetësisë së shtetit, siç rregullohet në ligjin e vendit nuk janë përmbushur (kjo aplikohet vetëm tek të miturit); ose
- Kur një fëmijë i birësuar fiton ose ka shtetësinë e huaj të një apo të të dy prindërve birësues.

Dispozitat kryesore të Konventës së 1961 të Kombeve të Bashkuara për Reduktimin e Pashtetësisë

Mbi dhënien e shtetësisë (Nenet 1, 2, 3 dhe 4)

Shtetësia jepet tek ata që në kushte të tjera do të ishin pashtetësi, të cilët kanë një lidhje efektive me shtetin, qoftë nëpërmjet lindjes, ose trashëgimisë. Shtetësia jepet:

- me lindje, për shkak të veprimit të ligjit tek personi i lindur në territorin e një Shteti;
- për shkak të veprimit të ligjit në një moshë të caktuar, tek personi i lindur në territorin e një Shteti, në vatësi të kushteve të ligjit vendas;
- me aplikim, tek personi i lindur në territorin e Shtetit (aplikimi mund të varet nga një apo më shumë prej faktorëve në vijim: një periudhë e caktuar gjatë të cilës mund të dorëzohet aplikimi, kërkesa specifike të qëndrimit, mungesa e dënimeve penale të një natyre të parashikuar dhe/ose që personi të ketë qenë gjithmonë pa shtetësi);
- me lindje, tek një fëmijë i ligjshëm, nëna e të cilit ka shtetësinë e shtetit ku ka lindur fëmija;
- me trashëgimi, nëse individi nuk është në gjendje ta fitojë shtetësinë e shtetit kontraktues në territorin e të cilit ai/ajo ka lindur për shkak të moshës ose kërkesave të shtetësisë (kjo mund të varet nga një ose më shumë prej faktorëve në vijim: një periudhë e caktuar gjatë të cilës mund të dorëzohet aplikimi, kërkesa specifike të qëndrimit dhe/ose që personi të ketë qenë gjithmonë pa shtetësi);
- tek fëmijët e braktisur të gjetur në territorin e Shtetit Kontraktues;
- me lindje, për shkak të veprimit të ligjit tek personi i lindur diku tjetër, nëse shtetësia e njërit prej prindërve në kohën e lindjes ishte ajo e Shtetit Kontraktues;
- me aplikim, ashtu siç rregullohet nga ligji i brendshëm, tek personi i lindur diku tjetër, nëse shtetësia e njërit prej prindërve në kohën e lindjes ishte ajo e shtetit kontraktues (aplikimi mund të varet nga një ose më shumë prej faktorëve në vijim: një periudhë e caktuar gjatë të cilës mund të dorëzohet aplikimi, kërkesa specifike

të qëndrimit, mungesa e dënimeve për një vepër kundër sigurisë kombëtare dhe/ose që personi të ketë qenë gjithmonë pa shtetësi).

Mbi humbjen ose heqjen dorë nga shtetësia (Nenet 5, 6, dhe 7)

Humbja, ose dorëheqja nga shtetësia duhet të kushtëzohet me posedimin paraprak ose sigurinë për fitimin e një shtetësie tjetër. Përjashtim mund të bëhet në rast të personave të natyralizuar, të cilët pavarësisht njoftimit për formalitetet dhe kufijtë kohorë banojnë jashtë vendit për një numër vitesh dhe nuk mbërrijnë të shprehin synimin për mbajtjen e shtetësisë. Individu i natyralizuar në këtë rast është personi që ka fituar shtetësinë me anë të aplikimit tek shteti kontaktues në fjalë, dhe ai shtet kontaktues mund ta ketë refuzuar aplikimin. Humbja e shtetësisë mund të ndodhë vetëm në pajtim me ligjin dhe duhet të jetë e shoqëruar me garanci të plota procedurale, si e drejta për dëgjim korrekt e transparent nga një gjykatë ose një trup tjetër i pavarur.

Mbi privimin e shtetësisë (Neni 8 dhe 9)

Askush nuk duhet të privohet nga shtetësia, nëse ai privim rezulton në pashtetësi, përveç kur:

- shtetësia është fituar me keq-përfaqësim ose mashtrim;
- individ ka kryer veprime të papajtueshme me detyrimin e besnikërisë, ose në shkëlqje/kundërshti të një ndalimi të shprehur, ose me sjellje personale seriozisht paragjyquese për interesat jetësore të Shtetit;
- individ ka bërë betim ose deklaratë formale për besnikëri ndaj një vendi tjetër ose ka refuzuar besnikërinë ndaj shtetit kontraktues;
- personi i natyralizuar që ka humbur lidhjen efektive me shtetin kontaktues dhe që pavarësisht njoftimit nuk mbërrin të shprehë synimin për mbajtjen e asaj shtetësie.

Shteti Kontaktues mund të privojë një individ nga shtetësia e tij vetëm mbi shkaqet e mësipërme, nëse ato janë përcaktuar specifikisht në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, ose aderimit dhe nëse janë në pajtim me ligjin dhe të shoqëruara nga garanci të plota procedurale, si e drejta e dëgjimit korrekt e transparent. Shteti kontaktues nuk mund të privojë një individ ose një grup individësh nga shtetësia e tyre mbi baza raciale, etnike, fetare ose politike.

Mbi transferimin e territorit (Neni 10)

Traktatet duhet të sigurojnë që pashtetësia nuk ndodh për shkak të transferimit të territorit. Kur nuk është nënshkruar traktati, shteti(et) i(të) përfshirë(a) duhet ta japë(in) shtetësinë e tij(e tyre) tek ata që në rrethana të tjera do të bëheshin pashtetësi si rezultat i transferimit ose fitimit të territorit.

Mbi një agjenci ndërkombëtare (Neni 11)

Konventa bën thirrje për themelimin, brenda kornizave të Kombeve të Bashkuara, të një trupi tek i cili një individ që pretendon përfitime nga Konventa mund të aplikojë për ta pasur kërkesën e tij/e saj të shqyrtuar dhe për t'u ndihmuar në prezantimin e asaj kërkesë tek autoriteti i duhur. Asambleja e Përgjithshme i ka kërkuar UNHCR-së ta përmbushë këtë përgjegjësi.

Mbi zgjidhjen e konflikteve (Neni 14)

Mosmarrëveshjet mes palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin ose aplikimin e Konventës që nuk janë zgjidhur me mënyra të tjera, do të dorëzohen tek Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë me kërkesën e secilës prej palëve në mosmarrëveshje apo konflikt.

Akti final

Akti Final rekomandon që personat që janë pa shtetësi de facto duhet, për sa është e mundur, të trajtohen si pa shtetësi de jure për t'u mundësuar atyre që të fitojnë një shtetësi efektive.

Shkaqe teknike

Përplasja/konflikti mes ligjeve

Probleme mund të dalin kur legjislacioni mbi shtetësinë në një prej Shteteve kontraktore bie në konflikt me atë të një Shteti tjetër, duke e lënë një individ pa shtetësinë e asnjë shteti. Ligjet respektive të të dy Shteteve apo kuadri ligjor I tyre mund të jenë hartuar si duhet, por problemet dalin atëherë kur ato zbatohen së bashku. Për shembull supozojmë se shteti A, në të cilin ka lindur individi, e jep shtetësinë vetëm me trashëgimi (jus sanguini), por prindërit e individit janë shtetas të një tjetër shteti; B. Nga ana tjetër, shteti B e jep shtetësinë vetëm në bazë të vendit të lindjes (jus soli) dhe, sipas ligjit të tij kombëtar, fëmijët e lindur nga një shtetas I vendit B por jashtë territorit të këtij të fundit, nuk e përfitojnë shtetësinë e vendit B në të gjithë situatat automatikisht. Pra individi mbetet pa shtetësi.

Për të shmangur këto probleme:

- Ashtu siç parashihet në Konventën e Hagës së 1930, secili shtet vendos sipas ligjeve të tij kush janë shtetasit e tij. Ky ligj i njohur nga shtetet e tjera duhet të jetë në pajtim me konventat ndërkombëtare, të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe parimet e njohura të së drejtës të aplikueshme për çështjet e shtetësisë. Shtetet pra duhet të këshillohen me një përmbledhje të freskuar të legjislacionit mbi shtetësinë dhe duhet të kuptojnë zbatimin e tyre në praktikë me qëllim zgjidhjen e konflikteve që lidhen me konceptin e shtetësisë. UNHCR mirëmban një përmbledhje të akteve ligjore për shtetësinë në [http:// www.ref world.org/statelessness.html](http://www.refworld.org/statelessness.html)
- Konventa e 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë pohon se shtetësia duhet të jepet:
 - me lindje, me anë të veprimit të ligjit tek një person i lindur në territorin e shtetit;
 - me anë të veprimit të ligjit në një moshë të caktuar tek një person i lindur në territorin e shtetit në vartësi të kushteve të ligjit kombëtar;
 - me aplikim, tek një person i lindur në territorin e shtetit (aplikimi mund të jetë në vartësi të një ose më shumë faktorëve në vijim: një periudhë e caktuar në të cilën aplikimi mund të parashtrohet, kërkesa të caktuara për rezidencën, mungesa e dënimeve penale të një natyre të treguar, dhe/ose që personi të ketë qenë gjithmonë pa shtetësi;)

- me trashëgimi, nëse individ i nuk ka mundësi të fitojë shtetësinë e shtetit kontraktues në territorin e të cilit ai/ajo ka lindur për shkak të moshës ose kërkesave për lejeqëndrim (kjo mund të varet prej një ose më shumë faktorëve në vijim: një periudhë e caktuar në të cilën aplikimi mund të parashtrohet, kërkesa të caktuara për lejeqëndrimin; dhe/ose që personi të ketë qenë gjithmonë pa shtetësi);
 - tek fëmijët e braktisur të gjetur në territorin e shtetit kontraktues;
 - me lindje, me anë të veprimit të ligjit, tek një person i lindur diku tjetër nëse shtetësia e njërit prej prindërve në kohën e lindjes ishte ajo e shtetit kontraktues;
 - me aplikim, siç parashihet nga ligji kombëtar, tek një person i lindur diku tjetër nëse shtetësia e njërit prej prindërve në kohën e lindjes ishte ajo e shtetit kontraktues (aplikimi mund të jetë në vartësi të një ose më shumë faktorëve në vijim: një periudhë e caktuar në të cilën aplikimi mund të parashtrohet, kërkesa të caktuara për lejeqëndrimin, të mos ketë kryer vepër kundër sigurisë kombëtare, dhe/ose që personi të ketë qenë gjithmonë pa shtetësi);
- Shumica e shteteve i kombinonjë parimet e jus soli dhe jus sanguinis në legjisllacionin e tyre të shtetësisë për të përcaktuar tërësinë fillestare të qytetarëve të një shteti dhe sesi qytetaria jepet me lindje. Ato shtete që nuk pranojnë shtetësinë e dyfishtë duhet të sigurojnë që në një moshë të caktuar, një individ ose prindërit e individit të kenë mundësinë të zgjedhin një shtetësi.

Konflikti i ligjeve të kanë të bëjnë me heqjen dorë

Disa shtete kanë ligje të shtetësisë që u lejojnë individëve të heqin dorë nga shtetësia e tyre pa fituar më parë, ose pa ju garantuar më parë fitimi i një shtetësie tjetër. Kjo shpesh çon në pashtetësi. Konflikte të ligjeve mbi këtë çështje mund të dalin kur një shtet nuk e lejon heqjen dorë nga shtetësia derisa individ i të ketë fituar fillimisht një shtetësi tjetër, ndërsa shteti tjetër i përfshirë nuk do ta japë shtetësinë e tij derisa individ i të mos ketë hequr fillimisht dorë nga shtetësia e tij/e saj origjinale. Disa herë një individ mund t'i kërkohej të heqë dorë nga një shtetësi e marrë diku tjetër, përpara se ai/ajo të mund të aplikojë për shtetësinë e vendit ku ai/ajo banon, pra duke e lënë personin pa shtetësi për aq kohë sa të jepet shtetësia e re.

Për të shmangur këtë problem:

- Sipas Konventës së 1961, mbi Reduktimin e Pashtetësisë, humbja ose heqja dorë nga shtetësia duhet të kushtëzohet me posedimin paraprak ose sigurinë për marrjen e një shtetësie tjetër.
- Legjisllacioni i shtetësisë duhet të përcaktojë që asnjë shtetas të mos heqë dorë nga shtetësia e tij/e saj pa fituar një shtetësi tjetër ose marrjen e garancive formale dhe me shkrim nga autoritetet kompetente që ai/ajo do të fitojë shtetësi tjetër.
- Konventa e 1961 në lidhje me Reduktimin e pashtetësisë lejon një përjashtim sipas të cilit personat e natyralizuar në një shtet pavarësisht njoftimit për formalitetet dhe kufijtë kohorë, banojnë jashtë vendit për një numër të caktuar vitesh dhe nuk mbërrijnë të shprehin vullnetin për mbajtjen e shtetësisë. Personi i natyralizuar në këtë rast është personi që ka fituar shtetësinë me anë të aplikimit tek Shteti Kontraktues në fjalë, dhe që shteti kontraktues mund ta ketë refuzuar aplikimin. Humbja e shtetësisë mund të zërë vend vetëm në pajtim me ligjin dhe e shoqëruar nga garanci të plota procedurale, si e drejta për dëgjim të drejtë e korrekt nga një gjykatë ose trup tjetër i pavarur.

- Disa shtete kanë prezantuar dispozita që lejojnë rifitimim e shtetësisë nëse individët e humbin ose nuk e fitojnë shtetësinë e një vendi tjetër.
- Për shtetet që nuk e pranojnë shtetësinë e dyfishtë ose të shumëfishtë, legjislacioni përkatës në lidhje me shtetësinë duhet të sigurojë që kërkesa për heqjen dorë ose humbjen e shtetësisë si parakusht për fitimin ose mbajtjen e shtetësisë, të shfuqizohet kur kjo heqje dorë ose humbje nuk është e mundur. Për shembull për refugjatët nuk duhet të pritet të kthehen ose të kontaktojnë autoritetet e vendit të tyre të origjinës për të lënë shtetësinë e tyre.

Praktikat më të mira: Federata Ruse

Shkëputja nga dhe ndarja e ish-Bashkimit Sovjetik, la miliona njerëz pa shtetësi. Në federatën e pavarur Ruse, rregullat e përcaktuara sipas Ligjit Federal mbi Shtetësinë I vitit 1991, parashikonin afate sipas të cilave kushdo që kishte një lejeqëndrimi të përhershme në territorin e Federatës Ruse mund të përfitonte shtetësinë ruse. Sipas të njëjta rregullave, individët të cilët nuk mund të provonin statusin e lejeqëndrimit të tyre të rregullt e të përhershëm në Federatën Ruse nuk gëzonin të drejtën që të përfitonin marrjen e shtetësisë Ruse.

Deri në fund të viteve 1990, shumë ish shtetas të Bashkimit Sovjetik në Federatën Ruse nuk kishin ndërmarrë asnjë hap për të rregulluar statusin e tyre në lidhje me shtetësinë e tyre, aty apo në ndonjë shtet tjetër në të cilin ata kishin lidhje të tjera. Disa, syresh ishin bërë automatikisht shtetas të shteteve të tjera të pavarura, ndonjëherë edhe në padijeni të vetë individëve të interesuar, ndërkohë që të tjerë mebtën pashtetësi për shkak se kushtet dhe situatat e tyre personale ishin të atilla që nuk ju mundësonin atyre kualifikimin për shtetësi aty, apo në ndonjë shtet tjetër gjtëkë.

Të ndërgjegjshëm që shumë shtetas sovjetikë mbetën pa një status të rregulluar të tyrin në Federatën Ruse, Qeveria Ruse nisi reformat në ligjin për Shtetësinë të vitit 1991. Ligji I rim bi shtetësinë në Federatën Ruse hyri në fuqi në 1 Korrik 2002 (Ligji I shtetësisë 2002), dhe amendimet e tjera të tij që do tju lehtësonin marrjen e shtetësisë ruse të gjithë shtetasve të ish Bashkimit Sovjetik, u kaluan në 2003.

Masat kyçe që rezultuan në reduktimin e pashtetësisë, kishin të bënin me disa masa të përkohshme që lehtësonin marrjen e shtetësisë ruse përmes natyralizimit të të gjithë shtetasve të ish Bashkimit Sovjetik bazuar në një leje qëndrimi të përkohshme apo të përhershme në territorin rus. Kjo procedure deri diku lehtësoi të gjitha kërkesat që ishin deri më tani të vështira për t'u plotësuar për shtetasit e ish Bashkimit Sovjetik që jetonin në territorin e Federatës Ruse me një status të papërcaktuar, më konkretisht provën e një qëndrimi pa shkëputje në territorin rus, për pesë vjet, provën për vetëmbështetje financiare si dhe aftësinë rrjedhshëm të gjuhës Ruse. Aplikantët e kësaj kategorie, gjithashtu u përjashtuan edhe nga tarifat e pagesës për natyralizimin. Përgjatë periudhës gjashtëvjeçare që kjo procedurë ishte në fuqi, një total prej 2,679,225 individësh kërkuan dhe u pajisën me shtetësinë Ruse, përmes natyralizimit, nga të cilët 575,044 ishin persona pa shtetësi. Ky rast përfaqëson një nga përpjekjet më të suksesshme për reduktimin e pashtetësisë në dhjetëvjeçarim e shkuar.

Në vijim të kësaj reforme, në 2012 Qeveria Ruse kaloi një sërë amendamentesh të tjera për të lehtësuar natyralizimin e atyre që mbetën pa shtetësi pavarësisht reformave të ndërmarra deri në atë kohë. Këto amendamente eliminuan/shmangën kërkesa të

tilla për aplikantët si; prova e regjistrimit të lejeqëndrimit. Në vijim, amendamentet shitesat e vitit 2012 shtrinë afatin e lehtësimit të natyralizimit për shtetasit e ish Bashkimit Sovjetik të cilët kërkuan dhe u pajisën me pasaporta të Federatës Ruse të cilat ishin shfuqizuar/anulluar pas një përcaktimi po nga ana e autoriteteve se ato ishin lëshuar si rezultat I një gabimi administrativ.

Ligje e praktika që ndikojnë vecanërisht tek fëmijët

Siç përcaktohet rregullohet edhe nga Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) dhe Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (CRC), të gjithë fëmijët, pavarësisht se ku kanë lindur, duhet të regjistrohen menjëherë sapo linden nga autoritetet e vendit ku kanë lindur. Të gjithë fëmijët kanë nevojë të kenë një shtetësi të përcaktuar. Shtetësia e fëmijës do të përcaktohet sipas ligjeve të shteteve të përfshira dhe të gjitha shtetet kërkojnë sqarime se ku ka lindur fëmija dhe nga kush. Pa dëshmi të lindjes, që do të thotë pa një regjistrim të njohur të lindjes, është shumë e vështirë për një fëmijë për të përcaktuar identitetin e tij/e saj dhe për rrjedhojë për të fituar një shtetësi.

Për të shmangur këtë problem:

- Shtetet duhet të ofrojnë burimet e nevojshme për administratën vendore relevante për të siguruar që regjistrimi i lindjes të kryhet në mënyrë sistematike në pajtim me nenin 7 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës (CRC) dhe nenin 24 të Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR.) Mbështetja nga komuniteti ndërkombëtar, sidomos nëpërmjet UNICEF, duhet të kërkohet nëse është e nevojshme.
- Kur regjistrohen lindjet Shtetet duhet të identifikojnë rastet e shtetësisë së diskutuar dhe duhet të japin qytetarinë nëse fëmija përndryshe mbetet pa shtetësi. Dispozitat relevante të Konventës së 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë duhet të përjetësohen në legjislacionin kombëtar pas aderimit në Konventë. Këto dispozita duhet të përjetësohen në legjislacionin e brendshëm edhe nëse shteti nuk ka aderuar në Konventën e 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë.
- Në vecanti shtetet duhet të kenë dispozita mbi marrjen e shtetësisë për fëmijët e lindur në territoret e tyre, të cilët në këtë rast janë pa shtetësi. Kjo gjë do të parandalonte pashtetësinë në rastet për shembull një fëmijë është i pamundur të marrë shtetësinë prindërve të tij/saj të huaj

Në shumë vende, grave nuk u lejohet ta kalojë shtetësinë e tyre tek fëmijët e tyre. Kjo mund të cojë në pashtetësi në rast se edhe babai I fëmijës është pa shtetësi, jo në dijeni apo I pamundur tja kalojë shtetësinë e tij fëmijës.

Për të shmangur këtë problem:

- Sipas Konventës së 1957 mbi Shtetësinë e Grave të Martuara dhe Konventës së 1979 mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, gratë duhet të kenë të drejta të barabarta me burrat në lidhje me shtetësinë e fëmijëve të tyre. Aplikimi i këtyre parimeve do të evitojë si diskriminimin kundër grave, edhe mundësinë që një fëmijë të trashëgojë statusin e pashtetësisë nga babai i tij/i saj, nëse ai është pa shtetësi.
- Shtetet duhet të përfshijnë dispozita mbi mos diskriminimin në bazë të seksit në kuadret ligjore të tyre kombëtare mbi shtetësisë.

Në Kenia në vitin 2010, u miratua një Kushtetute e re, e cila solli një reform në shkallë të gjerë e në një sërë fushash, përfshirë edhe shtetësinë. Kushtetuta e re dhe Akti I ri për Shtetësinë dhe Imigrimin përjetsojnë në kuadër të legjislacionit vendas një sërë masash dhe kushtesh kundra pashtetësisë, përfshirë këtu masat për dhënien e shtetësisë personave të braktisur. Gjithashtu parashikon barazi mes burrave dhe grave në lidhje me shtetësinë në gjithë kuadrin kombëtar.

Fëmijët jetimë dhe të braktisur shpesh nuk kanë një shtetësi të konfirmuar. Fëmijët e lindur jashtëligjshëm gjithashtu mund të pengohen nga fitimi i shtetësisë.

Për të shmangur këtë problem:

- Fëmijëve të braktisur të gjetur në territorin e shtetit duhet t'u jepet shtetësia e atij shteti. Ky parim gjendet në legjislacionin e shtetësisë të shumë shteteve dhe në instrumentet ndërkombëtare që lidhen me shtetësinë duke përfshirë edhe Konventën e 1961 në lidhje me Reduktimin e pashtetësisë.
- Aplikimi I parimeve që gjenden në traktatet e të drejtave të njeriut, që Shtetet nuk duhet të diskriminojnë fëmijët e lindur brenda apo jashtë martëses (e drejta ndërkombëtare mund të lejojë disa dallime në trajtimin e tyre në disa raste)
- Interesi më i mirë i fëmijës gjithmonë duhet të marrë konsideratën kryesore kur përcaktohet shtetësia e fëmijës.

Praktikat e birësimit të disa shteteve mund të çojnë drejt pashtetësisë, nëse p.sh. fëmijët nuk janë në gjendje të fitojnë shtetësinë e prindërve birësues.

Për të shmangur këto probleme:

- Shtetet duhet të prezantojnë dispozita në legjislacionin e tyre që garantojnë që birësimet e përfunduara jashtë vendit në pajtim me të drejtën ndërkombëtare të njihen nga ligji kombëtar.
- Konventa Evropiane e 1967 mbi Birësimin e Fëmijëve i inkurajon shtetet të lehtësojnë dhënien e shtetësisë tek fëmijët e birësuar të shtetasve të tyre.

Praktikat administrative

Ka një numër çështjesh administrative dhe procedurale që lidhen me marrjen, ri-dhënien, privimin dhe humbjen e shtetësisë. Edhe nëse një individ kualifikohet për shtetësi - në të vërtetë, edhe nëse një individ ka aplikuar në mënyrë të suksesshme për shtetësi - tarifata e larta administrative, afatet që nuk mund të kapen brenda kushteve të vendosura dhe/ose një paaftësi për të siguruar dokumentet e kërkuara pasi ato janë në posedim të shtetit të mëparshëm të shtetësisë, të gjitha këto mund ta pengojnë një individ nga fitimi i shtetësisë.

Pengesa të ngjashme mund të pengojnë për individët që e kanë marrë automatikisht shtetësinë e një shteti në pajisjen e tyre me dokumente identiteti si për shembull kartë identiteti, certifikatë shtetësie apo pasaportë, të cilat në vetvete do provonin shtetësinë e këtij të fundit në territorin e vendit ku ai ndodhet me këtë status shtetësie.

Për të shmangur këtë problem:

- Aplikimet që lidhen me fitimin, mbajtjen, humbjen, rifitimin ose certifikimin e shtetësisë duhet të procedohen brenda një kohe të arsyeshme. Këto procedura duhet të jenë sa më të thjeshta e publikuara në kohë e në mënyrë transparente.
- Regjistrimi i fitimit ose humbjes automatike (ex lege) së shtetësisë, përfshi situatat e bërjes palë të shtetit, për rezidentët e zakonshëm dhe tradicionalë nuk duhet të kërkojë deklarata me shkrim, megjithëse shtetet në përgjithësi këshillohen të mbajnë dëshmi me shkrim të të gjitha vendimeve të shtetësisë.
- Tarifat për fitimin, mbajtjen, humbjen, rifitimin ose certifikimin e shtetësisë dhe për shqyrtime administrative dhe gjyqësore të ngjashme duhet të jenë të arsyeshme sikundër dhe kërkesat për dokumentacionin.

Ligjet dhe praktikat që ndikojnë veçanërisht tek gratë

Disa shtete automatikisht e ndryshojnë statusin e shtetësisë së një gruaje kur ajo martohet me një jo shtetas. Një grua pastaj mund të bëhet pa shtetësi, nëse ajo nuk e merr automatikisht shtetësinë e bashkëshortit të saj, ose nëse burri i saj nuk ka shtetësi.

Një grua mund gjithashtu të shndërrohet në person pa shtetësi nëse, pasi ajo merr shtetësinë e bashkëshortit të saj, martesë zgjidhet e ajo humb shtetësinë e marrë si rezultat i martesës së saj, por shtetësia e saj origjinale nuk është automatikisht e rifitueshme.

Për të shmangur këtë problem:

- Konventa e 1957 mbi Shtetësinë e Grave të Martuara dhe Konventa e 1979 mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave ju jep grave të drejta të barabarta me burrat për fitimin, ndryshimin ose mbajtjen e shtetësisë. Në pajtim me parimet e këtyre konventave statusi i shtetësisë së bashkëshortit nuk duhet të ndryshojë automatikisht shtetësinë e bashkëshortes, ta lërë atë pa shtetësi dhe as të ofrojë fitim të detyruar për të të shtetësisë së tij.
- Në shtetet ku gratë nuk kanë të drejta të barabarta me burrat dhe mund të humbin automatikisht qytetarinë e tyre kur martohen ose kur gratë kanë lënë qytetarinë e tyre të mëparshme kur martohen, ato shtete duhet të prezantojnë dispozita në legjisllacionin e tyre të qytetarisë që u mundësojnë grave, martesat e të cilave janë zgjidhur, të rifitojnë automatikisht qytetarinë e tyre të mëparshme me anë të një deklarate të thjeshtë.

Humbja automatike e shtetësisë

Disa shtete ia revokojnë automatikisht shtetësinë një individ, i cili ka lënë vendin e tij ose i cili banon jashtë. Revokimi i shtetësisë, që mund të ndodhë vetëm disa muaj pas largimit të individit, shpesh shoqërohet me praktika administrative me defekte, në të cilat personi në fjalë nuk vihet në dijeni që ai/ajo rrezikon humbjen e shtetësisë së tij/ të saj nëse ai/ajo nuk regjistrohet rregullisht me autoritetet e vendit. Nëse individ është një shtetas i natyralizuar, dhe jo një që ka lindur në shtet ose që ka fituar shtetësinë me anë të trashëgimisë, edhe regjistrimi i rregullt mund të jetë i pamjaftueshëm për të garantuar që ajo shtetësi të mos revokohet. Pashtetësia shpesh është rezultat direkt i këtyre praktikave.

Për të shmangur këtë problem:

- Neni 7(3) i Konventës së 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë parasheh që një individ të mos e humbasë shtetësinë e tij/e saj dhe të bëhet pa shtetësi në bazë të largimit, rezidencës jashtë vendit, mos regjistrimit ose ndonjë arsye tjetër të ngjashme. Konventa e vitit 1961 përfshin një përjashtim nga ky parim në lidhje me personat e natyralizuar që jetojnë jashtë për më shumë se shtatë vite radhazi. Këta individë duhet të shprehin tek autoriteti kompetent dëshirën e tyre për të mbajtur shtetësinë e tyre për shembull duke rinovuar pasaportën e tyre. Shtetet pra duhet të informojnë siç duhet qytetarët e natyralizuar mbi këtë politikë si brenda kufijve të tyre dhe jashtë vendit me anë të shërbimeve të tyre konsullore.
- Instrumentet më të reja, si Konventa Evropiane mbi Shtetësinë, nuk u lejojnë shteteve të privojnë një person nga shtetësia e tij/e saj në bazë të faktit që individi zakonisht jeton jashtë vendit, nëse individi në fjalë do të bëhej kështu pa shtetësi.

Shkaqet që lidhen me suksesimin e shtetit

Transferimi i territorit ose sovranitetit

Megjithëse trajtohet vetëm pjesërisht në instrumente dhe parime specifike ndërkombëtare, transferimi i territorit ose i sovranitetit për një kohë të gjatë ka qenë shkak i pashtetësisë. Ligjet dhe praktikat kombëtare në mënyrë të pashmangshme do të ndryshojnë kur një shtet i nënshtrohet ndryshimeve të thella territoriale ose të sovranitetit, si p.sh. kur një shtet fiton pavarësinë nga një fuqi koloniale, pasi një shtet shpërbëhet, nëse një shtet i ri ose shtete të reja trashëgojnë shtetin e shpërbërë, ose nëse një shtet rikrijohet pas një periudhe shpërbërjeje. Secila prej këtyre ngjarjeve mund të nxisë miratimin e ligjeve ose dekreteve të reja të qytetarisë dhe/ose procedura të reja administrative. Individët mund të bëhen pa shtetësi në këto situata nëse ata nuk arrijnë të marrin shtetësinë sipas legjislacionit/dekreteve të reja ose procedurave të reja administrative, ose nëse atyre u mohohet shtetësia për shkak të riinterpretimit të ligjeve dhe praktikave të aplikuara më parë.

Për të shmangur këto probleme:

- Neni 10 i Konventës së 1961 mbi Reduktimi e Pashtetësisë parasheh se shtetet palë duhet të sigurojnë që pashtetësia të mos ndodhë si rezultat i transferimit të territorit. Shtetet duhet të nënshkruajnë traktate bilaterale ose multilaterale që përfshijnë dispozita për të siguruar që pashtetësia të mos ndodhë si rezultat i transferimit të territorit. Kur nuk është nënshkruar një traktat i tillë, shteti(et) në fjalë duhet t'ua japin shtetësinë atyre që në kushte të tjera do të mbeteshin pa shtetësi.
- Në praktikë popullatat zakonisht lidhen me territore; megjithatë disa traktate ndërkombëtare, dispozita kushtetuese dhe legjislacioni kombëtar ofrojnë gjithashtu mundësinë e shtetësisë nga shtetet trashëgimtare/pasuese.
- Traktatat ndërkombëtare mund të inkorporojnë gjithashtu dispozita që fokusohen sesi shpërbërja ose ndarja e shteteve mund të ndikojë tek shtetësia.

- Duke iu përgjigjur nevojës për kodifikim dhe zhvillim të së drejtës ndërkombëtare në lidhje me suksedimin e shteteve, Komisioni i të Drejtës Ndërkombëtare (ILC) i Kombeve të Bashkuara përgatiti draft nenet mbi çështjet që përmbahen në Aneksin e Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të KB 55/153 të 2001. Draft nenet parashohin që:
 - të gjitha shtetet e interesuara duhet të marrin masat e duhura me qëllim që personat që në datën e suksedimit të shteteve kishin shtetësinë e shtetit paraardhës të mos mbeten pa shtetësi si rezultat i suksedimit;
 - një person rezidenca e zakonshme e të cilit gjendej në territorin e ndikuar nga suksedimi i shtetit, supozohet se fiton shtetësinë e shtetit pasues në datën e suksedimit;
 - një shtet pasues nuk duhet t'ua japë shtetësinë tij personave, rezidenca e zakonshme e të cilëve ishte në shtetin tjetër kundër vullnetit të personave në fjalë, përveç nëse ata mbeten pa shtetësi në rrethana të tjera;
 - shtetet në fjalë duhet të marrin në konsideratë vullnetin e personave të interesuar kurdo që ata persona kanë të drejtë të fitojnë shtetësinë e dy ose më shumë shteteve. Çdo shtet i interesuar duhet të japë të drejtën e zgjedhjes së shtetësisë të atij shteti tek personat që kanë lidhjet e duhura me atë shtet nëse ata persona mbeten pa shtetësi në rrethana të tjera; dhe
 - shtetet e interesuara nuk duhet t'ua mohojnë personave të interesuar të drejtën të mbajnë ose fitojnë shtetësinë ose të drejtën e zgjedhjes së shtetësisë nëpërmjet diskriminimit mbi çfarëdolloj baze.
- Konventa Evropiane mbi Shtetësinë dhe Draft Protokollit i vitit 2006 mbi Mënjanimin e Pashtetësisë në lidhje me Suksedimin e Shteteve përjetësojnë dispozitat e Konventës së 1961 dhe shumë prej parimeve që gjenden në draft nenet e ILC-së. Konventa Evropiane i kushton një kapitull të tërë Suksedimit të Shteteve dhe Shtetësisë duke nënvizuar katër parime kryesore:
 - I- idhja e pastër dhe efektive mes personit të interesuar dhe shtetit;
 - rezidenca e zakonshme e personit të interesuar në kohën e suksedimit;
 - vullneti i personit të interesuar; dhe
 - origjina territoriale e personit të interesuar.

Për më tepër, Konventa Evropiane mbi Shtetësinë parasheh që jo shtetasit e shtetit paraardhës që janë rezidentë të zakonshëm në territorin mbi të cilin transferohet sovraniteti tek shteti pasues, duhet të kenë të drejtën të mbeten në atë shtet dhe të gëzojnë të njëjtat të drejta sociale dhe ekonomike si shtetasit.
- Konventa e Këshillit të Europës mbi Eliminimin e Pashtetësisë në raport me suksedimin e shteteve zhvilloi rregulla specifike të dëshmisë (neni 8) në lidhje me shtetësinë në rastet e suksedimit të shteteve:

“Një shtet suksesor/pasues do të insistojë në standardet e tij të dëshmisë të nevojshme për dhënien e shtetësisë së tij kur bëhet fjalë për persona që kanë mbetur ose do të kishin mbetur pa shtetësi si rezultat i suksedimit të shtetit dhe kur nuk është e arsyeshme për këta persona për të përmbushur kërkesat standarde.”

“Një shtet suksesor nuk do të kërkojë dëshmi të mos fitimit të shtetësisë tjetër para dhënies së shtetësisë së tij tek personat që kanë qenë rezidentë të zakonshëm në territorin e tij në kohën e suksedimit të shteteve dhe që kanë mbetur ose do të kishin mbetur pa shtetësi si rezultat i suksedimit të shteteve.”

Paragrafi një i Nenit 8 shqyrton situatën në të cilën është e pamundur ose shumë e vështirë për një person për të përmbushur kërkesat standarde të dëshmisë për të realizuar kushtet për fitimin e shtetësisë. Në disa raste mund të jetë e pamundur për një person për të siguruar dokumentacionin e plotë të dëshmisë së trashëgimisë së tij/së saj, nëse p.sh. arkivat e regjistrimit civil janë shkatërruar. Mund të jetë e pamundur për të ofruar dëshmi dokumentare të vendit të rezidencës në rastet kur vendi i rezidencës nuk ishte i regjistruar. Kjo dispozitë mbulon situatat kur mund të jetë e mundur për një person të ofrojë prova, por do të ishte e paarsyeshme për të kërkuar këto prova - për shembull, nëse ofrimi i provës do ta vendoste në rrezik jetën ose shëndetin e aplikantit. Rrethanat që e bëjnë të vështirë për të ofruar dëshmi nuk janë gjithmonë drejtpërdrejtë të lidhura me ngjarjen e suksedimit të shtetit. Ato mund të jenë pasojat e një ngjarjeje që ka ndodhur para ose pas suksedimit - për shembull kur nën regjimin e shtetit paraardhës regjistri civil është shkatërruar ose dokumente të rëndësishme nuk janë lëshuar për një segment të caktuar të popullatës. Në të gjitha rastet mundësia e lartë e provës dhe/ose dëshmia e pavarur do të jenë të mjaftueshme për të përmbushur kushtet e fitimit të shtetësisë të shtetit suksesor.

Paragrafi dy i Nenit 8 është i përshtatshëm vetëm kur shteti paraardhës është zhdukur dhe të gjithë personat që kanë shtetësinë e atij shteti e kanë humbur shtetësinë si pasojë automatike e shpërbërjes së shtetit. Nëse shteti i ri suksesor pengon ose zvogëlon numrin e shtetësive të shumëfishta, shteti mund të kërkojë dëshmi nga personi i interesuar që ai/ ajo nuk ka fituar një shtetësi tjetër ose që ai/ajo është pa shtetësi. Kërkesa për të provuar që personi nuk ka një shtetësi tjetër ose është pa shtetësi shpesh është e pamundur për t’u përmbushur, pasi varet nga bashkëpunimi me shtetet e tjera. Nëse ka rrezik që personi i interesuar mund të mbetet pa shtetësi si rezultat i suksedimit të shtetit, shteti suksesor nuk duhet të kërkojë dëshmi që personi i interesuar nuk ka një shtetësi tjetër ose është pa shtetësi para se t’i japë shtetësinë atij personi. Ky rregull bazohet në pikëpamjen dominuese që parandalimi i pashtetësisë është shqetësimi kryesor i komunitetit ndërkombëtar, ndërsa pranimi ose refuzimi i shtetësive të shumëfishta është një çështje për t’u vendosur nga çdo shtet individualisht.

Këto dispozita nuk e parandalojnë një shtet që dëshiron të reduktojë numrin e njerzve me shtetësi të shumëfishta në territorin e tij nga bashkëpunimi me shtetet e tjera dhe shkëmbimi i informacionit mbi fitimin ose humbjen e shtetësisë. Shtetësitë e shumëfishta mund të kundërshtohen nga dispozita e mosnjohjes së shtetësisë tjetër që gjendet në Konventën e Hagës së 1930 mbi Disa Çështje që lidhen me Konfliktin e Ligjeve të Shtetësisë dhe nga neni 7.1.a i Konventës Europiane për Shtetësinë, e cila parashihet mundësinë për humbjen automatike të shtetësisë kur një person fiton vullnetarisht shtetësinë tjetër. Një shtet gjithashtu mund t’i kërkojë individit në fjalë të bëjë një deklaratë me shkrim ku të deklarojë që ai/ajo nuk posedon dhe nuk do të posedojë shtetësi tjetër. Kjo do t’i mundësojë shtetit të anulojë qytetarinë e tij nëse/kur zbulohet më vonë që personi në fjalë ka bërë një deklaratë të rremë.

Roli i UNHCR-së



Megjithëse ka jetuar me një grua ukrainase për më shumë se një dhjetëvjeçar, ky Korean pa shtetësi, i cili është zhvendosur nga Uzbekistani në Ukrainë në vitin 1993, e ka patur të pamundur të rregjistrojë këtë bashkëshortësi. ©UNHCR/Greg Constantine, 2010

UNHCR ka qenë e përfshirë në çështje të pashtetësisë dhe me personat pa shtetësi që kur filloi veprimtarinë e saj në 1950. Organizata është ngarkuar nga Kombet e Bashkuara për të mbrojtur refugjatët dhe për t'i ndihmuar ata që të gjejnë zgjidhje për situatën e tyre të vështirë. Shumica e refugjatëve që ka ndihmuar organizata gjatë viteve kanë qenë gjithashtu pa shtetësi. Në të vërtetë, gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit është vendosur lidhja mes humbjes ose mohimit të mbrojtjes së shtetësisë dhe humbjes ose mohimit së shtetësisë. Tani gjithashtu është kuptuar gjerësisht se posedimi i një shtetësie efektive dhe mundësia për të ushtruar të drejtat e mishëruara tek shtetësia ndihmojnë në parandalimin e shpërnguljeve të personave në mënyrë jo vullnetare dhe të dhunshme. Që prej vitit 1995 mandati i kësja zyre është zgjeruar edhe më tej nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara për të përfshirë përgjegjësite lidhur me personat jo "refugjatë që janë pa shtetësi, dhe parandalimit e reduktimit të pashtetësisë në shkallë të gjerë. Këto rezoluta ishin të gjëra në qëllimshmërinë e tyre dhe nuk kufizojnë veprimtarinë e UNHCR-së në ato shtetet të cilat janë palë e konventave në lidhje me pashtetësinë.

Si u përfshi UNHCR-ja në çështjet e pashtetësisë?

Gjatë viteve roli i UNHCR-së në ndihmë të reduktimit të shpeshtësisë së rasteve të pashtetësisë dhe të personave pa shtetësi është rritur. Puna e saj në fushën e pashtetësisë është autorizuar nga rezoluta e Ansamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara si dhe përmes rekomandimeve të organave udhëheqëse që operojnë brenda vetë organizatës Komiteti Ekzekutiv i Programit të Komisionerit të Lartë (ExCom). ExCom është i përbërë nga përfaqësues të shteteve të ndryshme "87 vendejanë anëtare deri në Janar 2014" të zgjedhur nga ECODOC, dhe të bazuar mbi interesat e demonstruara në gjetjen e zgjidhjeve sa më të përshtatshme për problemet e refugjatëve.

Neni 11 i Konventës së 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë bën thirrje për themelimin "e një trupi tek i cili një individ që pretendon përfitime nga Konventa mund të aplikojë për shqyrtimin e kërkesës së tij dhe për t'u ndihmuar në prezantimin e saj tek autoriteti i duhur". Kur Konventa e vitit 1961 hyri në fuqi në 1975, Asambleja e Përgjithshme i kërkoi UNHCR-së ta përmbushë këtë rol. Përgjegjësitë e organizatës u përpunuan më tej në rezolutat e mëpasshme. Në lidhje me Konventën e 1954, Konkluzioni I ExCom 106 I vitit 2006 I miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, I bën thirrje UNHCR-së që "sigurojë këshillim teknik Shtetëvë Anëtarë për zbatimin e Konventës së vitit 1954, e në këtë mënyrë të siguronte një mbatueshmëri të vazhdueshme të të gjitha masave"

Në 1995 Komiteti Ekzekutiv i Programit të Komisionerit të Lartë miratoi një seri gjithë përfshirëse të udhëzimeve mbi çështjen e pashtetësisë: Konkluzioni mbi Parandalimin dhe Reduktimin e Pashtetësisë dhe Mbrojtjen e Personave Pa Shtetësi (Konkluzioni nr. 78). (ExCom përbëhet nga përfaqësuesit e vendeve- 66 vende ishin anëtare në janar 2005 - të zgjedhur nga ECOSOC në bazë të interesit të tyre të treguar për gjetjen e zgjidhjeve për problemet e refugjatëve.) Konkluzioni i ExCom i 1995 mbi pashtetësisë "inkurajon UNHCR-në të vazhdojë aktivitetet në emër të personave pa shtetësi" dhe "i kërkon UNHCR-së të promovojë në mënyrë aktive aderimin tek Konventa e 1954 mbi Statusin e Personave Pa Shtetësi dhe Konventa e 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë". Konkluzioni i ExCom i kërkon gjithashtu UNHCR-së "të promovojë në mënyrë aktive parandalimin dhe zvogëlimin e pashtetësisë me anë të shpërndarjes së informacionit dhe trajnimit të stafit dhe zyrtarëve qeveritarë; dhe të përmirësojë bashkëpunimin me organizata të tjera të interesuara".

Në 1996 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi një rezolutë (A/RES/50/152) që ngjashëm inkurajon Komisionerin e Lartë të vazhdojë aktivitetet në emër të personave pa shtetësi dhe të promovojë aderimin dhe implementimin e Konventave të 1954 dhe 1961.

Rezoluta gjithashtu i bën thirrje UNHCR-së “për të ofruar shërbime relevante teknike dhe këshillimore në lidhje me përgatitjet dhe implementimin e legjislacionit mbi shtetësinë tek shtetet e interesuara.”

Në të njëjtën rezolutë Asambleja e Përgjithshme “i bën thirrje shteteve për të miratuar legjislacionin mbi shtetësinë me një perspektivë nga zvogëlimi i pashtetësisë, në pajtim me parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare, veçanërisht duke parandaluar privimin arbitrar të shtetësisë dhe duke eliminuar dispozitat të cilat lejojnë heqjen dorë nga shtetësia pa posedimin ose fitimin paraprak të një shtetësie tjetër, ndërsa në të njëjtën kohë duke njohur të drejtën e shtetit për të nxjerrë ligje që rregullojnë fitimin, heqjen dorë dhe humbjen e shtetësisë.”

Pashtetësia është njohur si një prej shkaqeve bazë të shpërnguljeve dhe flukseve të refugjatëve në Planin e punës për Mbrojtje, (Agenda for Protection) e cila është mbështetur nga Komiteti Ekzekutiv i UNHCR-së (Konkluzioni Nr. 92 [LIII] a) dhe është mirëpritur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 2002.

Të shqetësuar me numrin tepër të lartë të personave pashtetësi, rastet e të cilëve kanë mbetur për shumë vite për mungesë neglizhence pa zgjidhje, në 2004, ExCom i bëri thirrje UNHCR-së të luajë një rol më aktiv, duke punuar me shtetet relevante për të gjetur zgjidhje për këto situata. Në vitin 2006 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Konkluzionin 106 të ExCom Mbi Identifikimin, parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë si dhe Mbrojtjen e personave pa shtetësi, që në të vërtetë *inter alia, konfirmon nevojën për UNHCR-në të:*

- Punojë me qeveritë e vendeve të ndryshme për të indentifikuar popullatat pa shtetësi dhe ato me shtetësi të papërcaktuar;
- Sigurojë mbështetje teknike dhe operacionale në lidhje me adoptimin dhe zbatimin e masave që duhen marrë kundrejt pashtetësisë si dhe të parandalojë ndodhshmërinë e pashëtësisë e cila rezulton në mohim arbitrar apo privim të shtetësisë tek individët;
- Bashkëpunojë me agjensitë e tjera të Kombeve të Bashkuara për të ndihmuar Shtetet të reduktojnë pashtetësinë, veçanërisht në situatat që janë manifestueshem pa shtetësi; dhe
- Të specializojë perms trajnimeve aktorët qeveritare mbi mekanizmat e përshtatshëm që ndihmojnë në identifikimin, rregjistrimin dhe marrjen e statusit të personit pa shtetësi.

Që prej vitit 2006, rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara kanë theksuar katër aspekte të mandatit të UNHCR-së; identifikimin, parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë si dhe mbrojtjen e personave pa shtetësi.

Çfarë bën UNHCR për të trajtuar problemin e pashtetësisë?

UNHCR-ja i ndihmon qeveritë në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit mbi shtetësinë, ofron trajnime e kualifikime për zyrtarët qeveritarë dhe rekomandonkomente mbi masat kushtetuese në legjislacionin për pashtetësinë në ato Shtete, ku një numër I madh njerëzish ndodhen ose në situatë të tillë pashtetësie apo në kushte të papërcaktuara sa I takon kësaj të fundit. Midis vitit 2011 dhe 2012, UNHCR promovoi një reform në legjislacionin mbi shtetësinë në 71 vende dhe siguroi këshillim teknik në lidhje me këtë kuadër në 41 vende.

UNHCR punon me parlamentet për të siguruar që legjislacioni mbi shtetësinë nuk çon tek shpërngulja dhe nuk përmban dispozita që mund të krijojnë pashtetësi. Udhëzimet e UNHCR-së mbi Sigurimin që cdo fëmijë të marrë shtetësinë përmes Nenev 1-4 te Koventës së vitit 1961 mbi Reduktimin e Pashtetësisë, japin një udhërrëfyes të qartë në lidhje me këtë aspekt.

UNHCR prezantoi sondazhin e parë mbarëbotëror të ndërmarrë nga shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara për të reduktuar pashtetësinë dhe për të përmbushur kriteret e mbrojtjes ndaj personave pa shtetësi në nevojë. Ky sondazh arriti në gjetjen se asnjë rajon në të gjithë botën nuk është imun ndaj pashtetësisë dhe që mangësitë e hapësirat boshe në kuadrin ligjor dhe institucional në lidhje me këtë çështje ende mbeten present sin ë nivel kombëtar ashtu edhe në nivel ndërkombëtar.

UNHCR ka ndërmarrë një sërë fushatash ndërgjegjësimi në të cilat shtetet e ndryshme kanë lejuar persona pa shtetësi ta marrin atë në territoret në të cilat ata kanë stabilizuar vendbanimet e tyre në mënyrë të përhershme apo për një kohë të gjatë.

UNHCR gjithashtu ndihmon drejtpërdrejt personat pa shtetësi duke u këshilluar me shtetet përkatëse në përpjekje për të gjetur zgjidhje afatgjata për individët ose grupet pa shtetësi. Kjo organizatë inkurajon shtetet për të sqaruar dhe rregulluar statusin ligjor për individët e interesuar dhe promovon njohjen e lidhjeve të ligjshme mes një individi ose grupi individësh dhe një shteti në rastet kur personi(at) e interesuar në rrethana të tjera do të ishin pa shtetësi.

Ndërsa presin për t'u zgjidhur statusi i tyre i shtetësisë, personat pa shtetësi kanë të drejtë të gëzojnë një minimum të drejtash në vendet e tyre të banimit/qëndrimit. UNHCR advokon për zbatimin rigoroz të Konventës së 1954 në lidhje me Statusin e Personave Pa Shtetësi, e cila nga ana e saj ofron një tërësi minimale të drejtash dhe detyrimesh për personat pa shtetësi dhe i ndihmon shtetet të zbatojnë në mënyrë korrekte, për sa është e nevojshme dhe për sa e lejojnë burimet, programe mbrojtjeje dhe ndihme për personat pa shtetësi. Manuli I UNHCR-së për Mbrojtjen e Personave pa Shtetësi ofron më tepër udhëzime sa l takon kësaj çështjeje.

Çfarë organizatash të tjera punojnë krahas UNHCR-së për adresimin e problemeve që lidhen me pashtetësinë?

Agjencitë kryesore të Kombeve të Bashkuara që punojnë me UNHCR-në për të trajtuar pashtetësinë janë Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (UNHCHR), Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara (UNICEF) dhe Fondi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara për Gratë (UnEomen). Për zgjidhjen e situatave të zgjata të pashtetësisë, UNHCR gjithashtu disa herë ka punuar me Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO), Fondin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Programin Botëror për Ushqim (ËFP) duke zbatuar bashkërisht programe për strehim, arsimim apo të gjenerimit të të ardhurave për të ndihmuar komunitetet e marginalizuara të integrohen ose riintegrohen në shoqërinë kombëtare.

Përveç organizatave të Kombeve të Bashkuara të përmendura më lart, UNHCR punon në bashkëpunim të plotë me mekanizmat relevante të trupave të traktateve të Kombeve të Bashkuara, që sigurojnë të drejtën e një shtetësie, si Komiteti për të Drejtat e Njeriut, Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial dhe Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave, Këshilli për të Drejtat e Njeriut dhe Procedura të tjera të vecanta të përshtatshme të Kombeve të Bashkuara .

UNHCR bashkëpunon me trupat rajonale, si Këshilli i Evropës, Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë, (OSBE), Organizata e Shteteve Amerikane, Unioni Afrikan, Liga e

Shteteve Arabe dhe Organizata e Konferencës Islamike. UNHCR merr pjesë në Komitetin e Këshillit të Evropës për Shtetësinë, i cili po zhvillon instrumente standarde, si Konventa Evropiane mbi Shtetësinë dhe Draft Protokollin për Mënjanimin e Shtetësisë në lidhje me Suksedimin Shtetëror.

Organizatat jo-qeveritare gjithashtu punojnë ngushtë me UNHCR-në në fusha të tilla si advokimi e lobimi për programet e UNHCR-së si dhe ndihmojnë në zhvillimin e aktiviteteve të kësja të fundit.

UNHCR punon ngushtë me Unionin Ndërparlamentar (IPU) për rritjen e ndërgjegjësimit mes parlamentarëve në lidhje me normat ligjore ndërkombëtare mbi shtetësinë dhe për t'i ndërgjegjësuar ata për tërësinë e rekomandimeve dhe praktikave të mira që mund të parandalojnë pashtetësinë. Organizata inkurajon parlamentarët të miratojnë legjislacionin mbi shtetësinë që do të ndihmojë në eliminimin e pashtetësisë ndërsa siguron të drejtën për një shtetësi tek të gjithë ata që janë të privuar nga ajo, dhe ndihmon për të siguruar që traktatet që trajtojnë shtetësitë e dyfishta ose të shumëfishta të mos krijojnë pashtetësi nga pakujdesia.

Praktikat më të mira: Sri Lanka

Shumica e forcës punëtore që prodhon çajin e njohur botërisht të Sri Lankës është me origjinë indiane. Të njohur zyrtarisht si "tamilë me origjinës të vonë indiane," por që më shpesh thirren si "tamilë të epërm," këta punëtorë janë pasardhës të personave të sjellë nga India në atë çfarë atëherë ishte quajtur Ceilon nga administrata britanike që qeverisi vendin ishull nga 1815 deri më 1948. Nga 1948, kur Sri Lanka fitoi pavarësinë e saj deri më 1984, marrëveshje të ndryshme indiano-sri lankeze përcaktuan statusin ligjor të këtyre punëtorëve. Disa tamilëve të epërm iu dha shtetësia nga njëri vend apo tjetri me anë të rregullimeve legjislative ose marrëveshjeve bilaterale. Megjithatë shumë nuk kishin shtetësi dhe për rrjedhojë as të drejta bazë; disa nuk kishin qasje as në procesin e fitimit të qytetarisë sri lankeze ose indiane.

Në 1982 qeveria e Indisë informoi qeverinë e Sri Lankës se i konsideronte marrëveshjet e mëparshme në lidhje me tamilët e epërm se nuk kishim më fuqi detyruese, pasi periudha e zbatimit të këtyre marrëveshjeve kishte skaduar. Në fakt nga ajo datë çdo tamil i epërm që ishte pashtetësi nuk ishte në gjendje të fitonte shtetësi.

Kongresi i Punëtorëve të Ceilonit, një sindikatë dhe parti politike, lloboi për vite për të drejtat e tamilëve të epërm. Si përgjigje, parlamenti i Sri Lankës draftoi dhe përfundimisht në tetor 2003 aprovoi "Aktin për Dhënien e Shtetësisë Personave me Origjinë Indiane". Akti i jep automatikisht shtetësinë çdo personi me origjinë indiane që:

- Ka statusin e rezidentit të përhershëm në Sri Lanka që nga 30 tetori 1964, ose
- Është pasardhës, rezident në Sri Lanka, i një personi që ka qenë rezident i përhershëm i Sri Lankës që nga 30 tetori 1964.

Pas miratimit të Aktit, Zyra e Komisionerit të Përgjithshëm, UNHCR dhe Kongresi i Punëtorëve të Ceilonit filluan shpërndarjen e informacionit mbi ligjin e ri. Media tamileze, angleze dhe sinhaleze botuan artikuj në gazeta dhe transmetuan klipe në radio dhe televizione me informata mbi ligjin dhe se ku dhe si mund të aplikoni njerëzit për shtetësinë.

Procedurat administrative, të hartuara/përcaktuara nga Ministria e Brendshme dhe Kontrollori i Departamentit të Emigrimit, janë të thjeshta, të shkurtra dhe të drejta. Dy procedura të ndryshme u krijuan për personat pa shtetësi.

- Personave pa shtetësi de facto, zakonisht mbajtës së pasaportave indiane që kishin skaduar pas deklaratës së 1982 të Indisë, iu kërkua të deklaronin qëllimin e tyre për të fituar vullnetarisht shtetësinë sri lankeze. Kjo bëhet zakonisht nga kryetari i familjes. Dokumenti që tregon këtë synim pastaj duhet nënshkruar nga autoritetet e emigracionit. Sapo të aprovohet kjo kërkesë/deklaratë të gjithë anëtarëve të familjes u jepet shtetësia.
- Personat pa shtetësi de jure nuk kanë nevojë të dorëzojnë deklaratë me shkrim, megjithëse ata inkurajohen të nënshkruajnë një deklaratë të vecantë që kur kundër-nënshkruhet nga ana e zyrtarëve qeveritarë, e bën më të lehtë për ta fitimin e dokumenteve të identifikimit.

Të dy procedurat janë pa pagesë dhe nuk ka afat për aplikim.

Në dhjetor 2003 UNHCR dhe Kongresi i Punëtorëve të Ceilonit organizuan një punëtori një ditore për mbi 500 vullnetarë, të cilët pastaj punuan tek 50 qendra të lëvizshme, të shpërndara nëpër të gjithë rajonin e plantacioneve të çajit, ku personat pa shtetësi aplikonin për shtetësi. Vullnetarët u trajnuan mbi faktet bazë të pashtetësisë, mbi ligje të ndryshme relevante të miratuara që nga 1948 dhe mbi ligjin e ri dhe kriteret e tij të kualifikimit.

Për 10 ditë në dhjetor 2003 stafi i qendrave të lëvizshme pranoi aplikime për shtetësi. UNHCR financoi fushatën dhe monitoroi procesin për të siguruar që aplikantët të merrnin vendime të informuara dhe me vullnetin e tyre. Në fund të atij muaji rreth 190,000 kryefamiljarë kishin fituar shtetësinë sri lankeze. Prej tyre rreth 80,000 kishin pasur më parë pasaporta indiane; pjesa e mbetur kishin qenë persona pa shtetësi de jure.

Në korrik dhe gusht 2004, një fushatë e dytë më e vogël u organizua në pjesën verilindore të vendit. Mbi 2,000 persona pa shtetësi aplikuan dhe fituan shtetësinë. Që atëherë një numër i tamilëve të epërm kanë aplikuar në mënyrë të suksesshme për shtetësi, qoftë nëpërmjet agjentit të qeverisë në rrethin/zonën e tyre lokale, qoftë nëpërmjet sektorit të shtetësisë së Ministrisë së Sigurisë Publike, Ligjit dhe Rendit në kryeqytetin, Kolombo

Kush i financon aktivitetet e UNHCR-së?

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) është një prej të paktave agjenci të Kombeve të Bashkuara që varet pothuajse krejtësisht nga kontributet vullnetare për financimin e veprimtarisë së saj. Rreth pesë për qind e buxhetit vjetor të UNHCR-së vjen prej kontributeve të llogaritura të buxheti të rregullt të Kombeve të Bashkuara; pjesa tjetër është kontribut mbi baza vullnetare nga qeveritë, individët si dhe sektori privat.

Në fillim të vitit 2013, në interes të veprimtarisë dhe mandatit të UNHCR-së llogariteshin 35.8 milion persona. Ndërkohë buxheti i UNHCR-së për vitin 2012 ishte 4.3 miliardë dollar US\$ nga të cilat 62 milion ishin fonde të dedikuara për çështjet e pashtetësisë.

Në vitin 2012, UNHCR pranoi 77 për qind të fondeve të saj nga dhjetë qeveritë më të mëdha donator në botë. Në të njëjtën kohë, ajo mori 130 milion dollar amerikanë US\$ nga sektori privat kryesisht i përqëndruar në Europë, Australi, Japoni, Katar dhe Shtetet e Bahskuara të Amerikës. Organizatat jo-qeveritare (OJQ) kontribuojnë në buxhetin vjetor të UNHCR-së duke ndërmarrë apele dhe thirrje publike në emër të çështjes për të cilën punon UNHCR dhe veprimtarive të saj. Vitet e fundit kontributet e sektorit privat dhe të OJQ-ve janë rritur ndjeshëm si rezultat i përpjekjeve të përqëndruara për të rritur ndërgjegjësimin publik përmes radios, televizionit, medias së shkruar dhe atyre sociale.

Si mund të ndihmojnë parlamentarët



Një vendim i Gjykatës së Lartë i vitit 2008 ripohoi që folësit e gjuhës urdu, ashtu si edhe këta djem në Mohammadpur, Daka, janë shtetas Bangladeshas. Gjykata rekomandoi që qeveria e Bangladeshit t'i rehabilitonte folësit e gjuhës urdu, tu jepte atyre karta identiteti që tregojnë shtetësinë dhe t'i rregjistronte ata si votues. © UNHCR / S. I. Hossain, 2013.

Parlamentarët janë në një pozitë unike për të ndihmuar në uljen e pashtetësisë e për të siguruar që individëve pa shtetësi tu jepen të drejtat dhe ata të plotësojnë detyrimet që u njihen atyre nga e drejta ndërkombëtare. Parlamentarët mund ta bëjnë këtë në disa mënyra: duke rishikuar legjislacionin për shtetësinë dhe duke siguruar që ai të jetë në përputhje me standartet ndërkombëtare; duke nxitur nënshkrimin në konventat e viteve 1954 e 1961; si edhe duke propaganduar uljen ose zhdukjen e pashtetësisë si edhe për zgjidhjen e çështjeve që përfshijnë personat pa shtetësi.

Për çfarë duhet të kërkojnë parlamentarët teksa merren me rishikimin e legjislacionit kombëtar në lidhje me pashtetësinë?

- Te rishikojnë traktatet ndërkombëtare apo rajonale përkatëse në të cilat është palë ai shtet. Të rishikojnë traktatet, konventat dhe deklaratat të cilave shteti u referohet në legjislacionin e brendshëm; të cilat do të jenë një ndihmë në interpretimin e kuadrit ligjor të brendshëm.
- Duke qenë se shumë shtete i pasqyrojnë dispozitat që lidhen me shtetësinë në një sërë instrumentesh të ndryshme ligjore, të rishikojnë kushtetutën, ligjet për shtetësinë, dekretet dhe të gjithë burimet e së drejtës së brendshme të cilat mund të hedhin dritë mbi legjislacionin e një shteti dhe mbi interpretimin që i ai bën ligjeve.
- Të rishikojnë marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe të miratuara në rastet e ndarjes ose trashëgimisë së shteteve.
- Kur të jenë duke rishikuar kuadrin e brendshëm ligjor, të përcaktojnë nëse ai shtet siguron adoptimin dhe përdorimin sistematik të klauzolave ligjore rezerve për të parandalu lindjen e pashtetësisë, pashtetësi e cila nga ana e saj rrjedh si rezultat i privimit, heqjes dorë apo humbjes së shtetësisë.

Gjatë rishikimit të kuadrit ligjor të brendshëm, përpikuni për t'iu dhënë përgjigje pyetjeve në vijim:

Për fitimin e shtetësisë

- A mund të përftojnë fëmijët shtetësinë e nënës, sidomos në rastet kur babai nuk ka shtetësi, kur ai nuk është i pranishëm apo nuk mund të vërtetojë shtetësinë e tij?
- A siguron legjislacioni i brendshëm i shtetit përfitimin e shtetësisë për ata që kanë lindur në territorin e atij shteti e të cilët ndryshe do të mbeteshin pa shtetësi?
- A zbatohet parimi i mosdiskriminimit edhe për rregullat e njohjes së shtetësisë?
- Nëse krijimi i shtetit erdhi si rrjedhim i suksedimit (vijimësisë) nga një shtet tjetër, si minimum, a merren parasysh vendbanimi i zakonshëm i personit në fjalë në kohën e këtij suksedimi, vullneti i këtij personi në fjalë, si edhe prejardhja territoriale e personit kur përcaktohet nëse shtetësia do t'i jepet një shtetasi të shtetit paraardhës?

Për humbjen apo privimin nga shtetësia

- A sigurojnë dispozitat që lidhen me ndryshimin e statusit martesor apo të një statusi tjetër shoqëror që të shmanget pashtetësia?
- Si hiqet dorë nga shtetësia? A parashikohet parandalimi i pashtetësisë?
- A kushtëzohet heqja dorë nga shtetësia me fitimin apo garantimin e fitimit të një shtetësie tjetër?

- A e ndryshon statusin e shtetësisë së një individi aplikimi për natyralizim në një shtet tjetër, nëse personi i interesuar nuk ka marrë ende asnjë garanci se do ta fitojë atë shtetësi tjetër?
- Në rastet kur parashikohet privimi nga shtetësia, a janë të parashikuara qartë arsyet për këtë privim? A mundet që privimi nga shtetësia të çojë në pashtetësi? A ka garanci procedurale për këtë qëllim?

Për rifitimin apo rimëkëmbjen e shtetësisë

- A lehtësohet rifitimi i shtetësisë për ish shtetësit të cilët janë banorë të ligjshëm dhe të zakonshëm në territorin e shtetit?
- A mund të jepet sërish apo të rivendoset shtetësia për dikë që e humb shtetësinë e fituar për shkak të një ndryshimi në statusin e vet martesor apo në ndonjë status tjetër? Nëse po, a do të ndodhë kjo rivendosje vetvetiu apo personi duhet të aplikojë për këtë rivendosje ndërsa është pa shtetësi? A ka garanci procedurale për këtë?

Për natyralizimin

- Nëse një i huaj kërkon të natyralizohet, a i kërkohet atij që të japë prova të heqjes dorë formalisht nga një shtetësi e mëparshme? Ose a është e mjaftueshme garancia që ai do të lirohet nga një shtetësi e mëparshme pas përfimit të shtetësisë së re?
- A janë të përcaktuar qartësisht proçesi i natyralizimit dhe kërkesat për natyralizim?
- A ka ndonjë praktikë administrative “të tilla si proçedurat e stërzgjatura, tarifat e tepruara, kërkesat për dokumenta që aplikuesi nuk mund t’i sigurojë dhe / ose afate shumë të shkurtra që aplikuesi nuk mund t’i arrijë” të cilat mund të sjellin si pasojë gjendje pashtetësie?

Për përfitimin e provës së identitetit dhe të shtetësisë

- Cila është proçedura administrative për të rregjistruar lindjet? A përdoret ajo në praktikë? Nëse ka një afat për rregjistrimin e lindjes, a mund të rregjistrohen lindjet më vonë në vijim?
- A ka ndonjë praktikë administrative “të tilla si proçedurat e stërzgjatura, tarifat e tepruara, kërkesat për dokumenta që aplikuesi nuk mund t’i sigurojë dhe / ose afate shumë të shkurtra që aplikuesi nuk mund t’i arrijë” të cilat mund të sjellin si pasojë vështirësi në përfitimin e një prove të shtetësisë?

Pse shtetet duhet të bëhen palë në Konventën e vitit 1954 dhe në Konventën e vitit 1961?

Në nivel kombëtar, hyrja në Konventat e vitit 1954 dhe 1961 për pashtetësinë:

- është një mënyrë për shtetet që të tregojnë përkushtimin e tyre për t’i trajtuar personat pa shtetësi në përputhje me të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht dhe me standartet humanitare, duke përfshirë këtu të drejtën për të gëzuar një shtetësi;
- siguron që personat pa shtetësi të kenë akses tek mbrojtja e një shteti me qëllim që ata të jenë të aftë ta jetojnë jetën e tyre në siguri dhe me dinjitet;
- siguron një kuadër për të identifikuar personat pa shtetësi brenda territoreve të

shteteve dhe për të siguruar gëzimin e të drejtave të tyre, përfshirë këtu përmes lëshimit të dokumentave të identitetit dhe të dokumentave të udhëtimit;

- mundëson shtetet që të shtrojnë për zgjidhje boshllëqet që vijnë nga përjasjet e ndryshme për përfitim të shtetësisë anëmbanë botës përmes njohjes së klauzolave të përbashkëta siguruese për shmangien e pashtetësisë, pa vënë në diskutim sovranitetin e shteteve mbi rregullimin e shtetësisë; dhe
- rrit sigurinë dhe qëndrueshmërinë duke shmangur përjashtimin dhe mënjanimin e personave pa shtetësi.

Në nivel ndërkombëtar, hyrja në Konventat e vitit 1954 dhe 1961 për pashtetësinë:

- tregon një përkushtim për të bashkëpunuar me bashkësinë ndërkombëtare për uljen dhe zhdukjen e pashtetësisë;
- nxit njohjen e statusit ligjor ndërkombëtar të “personit pa shtetësi” dhe të kuadrit të përbashkët ndërkombëtar për mbrojtjen, duke rritur kështu transparencën dhe parashikueshmërinë e mënyrës se si shtetet i përgjigjen pashtetësisë;
- përmirëson marrëdhëniet ndërkombëtare dhe stabilitetin ndërkombëtar;
- ndihmon për të parandaluar shpërnguljen duke shtruar për zgjidhje shkaqet e saj;
- ndihmon UNHCR për të vënë në lëvizje mbështetjen ndërkombëtare për tui bashkuar parimeve që përmbahen në këto konventa; dhe
- ndihmon në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lidhura me shtetësinë.

Si mund të bëhet një shtet pjesë e Konventës?

Shtetet mund të anëtarësohen në Konventat e vitit 1954 dhe / ose 1961 në çdo kohë duke depozituar një instrument të hyrjes tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Instrumenti i hyrjes duhet të nënshkruhet nga Kreu i Shtetit apo i Qeverisë apo nga Ministri i Jashtëm e pastaj të përcillet përmes përfaqësuesit të vendit në Qendrën e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork (Neë York). (Shembuj të instrumenteve të hyrjes jepen tek Shtojca 3).



A mund të bëjë një shtet rezervime ndaj Konventave?

Duke njohur kushtet e posaçme që mund të jenë në veprim në shtete të caktuara në kohën e ratifikimit apo hyrjes, Konventat i lejojnë Shtetet Kontraktuese që të bëjnë rezerva ndaj disave prej dispozitave të Konventave, përveçse për ato dispozita që vlerësohet se janë themelore nga ana e Shteteve Kontraktuese fillestare:

Konventa e vitit 1954: rezervat lejohen përveçse për Nenet 1 (përkufizimi / klauzolat e përjashtimit), 3 (mosdiskriminimi), 4 (liria e besimit), 16 (1) (aksesi tek gjykatat), dhe nenet nga 33 deri në 42 (Dispozitat përfundimtare).


Konventa e vitit 1961: rezervat lejohen vetëm në lidhje me Nenin 11 (agjencia), nenin 14 (referimi i mosmarrëveshjeve tek Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë), ose nenin 15 (territoret për të cilat është përgjegjës Shteti Kontraktues).

Shtetet anëtare të Konventës së 1954 dhe asaj të vitit 1961 Deri në 1 Maj 2014



- Shtetet që ende nuk janë bërë palë të asnjërës Konventë
- Shtetet anëtare vetëm të Konventës të vitit 1954
- Shtetet anëtare vetëm të Konventës të vitit 1961
- Shtetet anëtare edhe të Konventës të vitit 1954 dhe asaj të 1961

Britja e numrit të ratifikimeve të dy Konventave të vitit 1954 dhe 1961



Si mund të sigurojnë parlamentarët që konventat për pashtetësinë vihen në jetë efektivisht?

Në shumicën e Shteteve, duhet të përshtatet apo të shtohet legjislacioni i brendshëm me qëllim që të lejohet që dispozitat e dy konventave për pashtetësinë të mund të vihen në jetë efektivisht. UNHCR mund të ofrojë këshillimin e saj prej agjencie eksperte ndaj shteteve që të ndihmojnë të sigurohet që burimet dhe traditat e veçanta ligjore të çdo shteti të mundësojnë plotësimin e detyrimeve të tij ndërkombëtare.

Çfarë hapash praktike mund të ndërmarrin parlamentarët për të nxitur qeveritë e tyre që të anëtarësohen në këto Konventa?

- Të përcaktojnë nëse shteti është palë në ndonjërin apo në të dyja konventat për pashtetësinë.
- Nëse shteti nuk është anëtarësuar ende në këto instrumenta, të marrin në shqyrtim mundësinë e paraqitjes së një kërkesë verbale apo me shkrim ndaj qeverisë ose atë të paraqitjes së një ligji të miratuar nga ata vetë me nismën e tyre.
- Nëse para parlamentit është paraqitur një kërkesë për ratifikim apo hyrje, të votojnë në favor të kësaj hyrje brenda një kohe të arsyeshme pasi të kenë marrë në shqyrtim informacionin e nevojshëm.
- Nëse qeveria nuk arrin ta sjellë çështjen në parlament brenda një kohe të arsyeshme, të përdorin procedurat parlamentare për t'i kërkuar qeverisë që të japë shpjegime për këtë vonesë dhe të nxisë qeverinë që të nisë pa vonesë procesin e ratifikimit ose të hyrjes.

- Nëse ai vend është nja nga shtetet e pakta që kanë nënshkruar një rën apo të dyja konventat për pashtetësinë por që ka vonuar proçesin e ratifikimit, të përdorin proçedurat parlamentare për t'i kërkuar qeverisë që të japë shpjegime për këtë vonesë dhe të nxisë qeverinë që ta përshpejtojë proçesin. Të përdorin të drejtën e tyre për të ushtruar nismën legjislative për të paraqitur një projekt ligj për këtë çështje.
- Nëse qeveria kundërshton ratifikimin apo hyrjen, të përiqen të gjejnë me hollësi arsyet pse. Nëse është e nevojshme, të ndihmojnë për të larguar dyshimet dhe keqkuptimet dhe të përdorin rrjetin e tyre politik për të përshpejtuar proçesin. Të bëjnë mbrojtjen e duhur para zgjedhësve të tyre për përparimin e çështjes së ratifikimit ose të hyrjes.
- Në rastin e parlamentarëve të një shteti të krijuar nga ndarja apo shpërbërja e shteteve të tjera, traktatet tek të cilat ishte anëtarësuar shteti paraardhës nuk janë vetvetiu të detyrueshme për shtetin e ri. Shtetet e reja mund të ndjekin detyrimet e shtetit paraardhës, të anëtarësohen si shtete të reja apo të shprehin qëllimin e tyre për të mos u kufizuar nga traktatet e arritura nga shteti paraardhës.
- Pasi konventat për pashtetësinë të jenë ratifikuar apo shteti të jetë anëtarësuar në to, të sigurohen që parlamenti të miratojë një legjislacion të brendshëm që i korrespondon dispozitave që përmbahen në konventat për pashtetësinë. Të përdorin proçedurat parlamentare për të siguruar që qeveria të dërgojë në parlament projektligje apo shtesa për ligjet ekzistuese brenda një kohe të arsyeshme.
- Nëse qeveria i ka dërguar parlamentit një kërkesë për ratifikim apo hyrje të shoqëruar nga rezerva që kufizojnë qëllimin e zbatimit të konventës, kundërshtime apo deklarata të mirëkuptimit, e ata vënë re që këto kufizime janë të pabaza, të nxisin interesin e përgjithshëm mbi interesat sektare apo rrethanore.
- Nëse rezervat e qeverisë për kufizimin e qëllimit të konventës, kundërshtimet e saj apo edhe deklaratat e saj të mirëkuptimit nuk janë më të vlefshme, të përdorin proçedurat parlamentare për të gjetur qëllimet e qeverisë, si edhe për të ndërmarrë veprime me qëllimin e heqjes së këtyre kufizimeve.
- Nëse kërkohen këshilla dhe ndihmesë për ratifikimin ose hyrjen dhe / ose hartimin e legjislacionit të brendshëm që i përmbahet parimeve të parashikuara në konventat për pashtetësinë, të kontaktojnë zyrën e UNHCR që ndodhet në atë shtet apo që është përgjegjëse për atë shtet.

Si mund të rrisin parlamentarët ndërgjegjësimin në lidhje me çështjen e pashtetësisë?

Si personat përgjegjës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të vendit të tyre, parlamentarët janë në një pozicion të shkëlqyer për të mbrojtur zhdukjen ose uljen e pashtetësisë dhe për të siguruar që të drejtat e personave pa shtetësi të mbrohen. Parlamentarët jo vetëm që duhet të nxisin qeveritë e tyre që të miratojnë ligje që janë në përputhje me standartet ndërkombëtare por ata gjithashtu duhet që të fitojnë mbështetjen e zgjedhësve të tyre. Vetëm kur shoqëria civile të kuptojë problemet që janë të bashkëngjitura me pashtetësinë, atëherë ajo do të mbështesë përpjekjet e parlamentarëve për t'i zgjidhur këto probleme.

Parlamentarët mund të rrisin ndërgjegjësimin mes zgjedhësve të tyre në lidhje me pashtetësinë duke mbajtur fjalime për të dhe për rëndësinë e një legjislacioni të brendshëm të qëndrueshëm, duke shkruar në gazeta artikuj për nevojën për të zhdukur pashtetësinë, duke punuar me organizatat joqeveritare dhe me aktorë të tjerë të shoqërisë civile të

cilët i ndihmojnë personat pa shtetësi dhe atje ku është e praktikueshme, duke mbrojtur zgjidhjen e shpejtë të rasteve individuale të pashtetësisë.

Parlamentarët mund t'i zgjidhin gjendjet e pashtetësisë duke nxitur të drejtat e pakicave apo të grupeve të tjera për tu bërë pjesë e atij trupi qytetarësh që përbëjnë shtetin, si edhe duke nxitur dialogun ndërmjet bashkësive çka do të çojë në pranimin e individëve pa shtetësi si shtetas.

Çfarë mund të bëjnë parlamentarët për të nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar për këtë çështje?

Bashkëpunimi ndërkombëtar është thelbësor për uljen e rasteve të pashtetësisë kudo në botë. Parlamentarët duhet të sigurojnë që qeveritë e tyre të marrin pjesë plotësisht në të gjitha përpjekjet ndërkombëtare për të ulur apo zhdukur pashtetësinë dhe në të gjitha veprimtaritë për të zgjidhur rastet individuale të pashtetësisë.

Parlamentarët mund të shqyrtojnë mundësinë që të ftojnë parlamentarë të vendeve fqinje për të bërë një rishikim rajonal të legjisllacionit të tyre për shtetësinë. Harmonizimi i ligjeve për shtetësinë ndërmjet shteteve është një mënyrë e mirë për të ulur rastet e pashtetësisë.

Shtojca 1

Shtetet palë në Konventën e vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave pa Shtetësi

Data e hyrjes në fuqi: 6 qershor 1960

Numri i përgjithshëm i shteteve palë (në 1 maj 2014): 80

Shteti	Nënshkrimi	Ratifikimi (r), Hyrja (a), Suksedimi / vijimësia (s)
Shqipëri		23 Qershor 2003 a
Algjeri		15 Korrik 1964 a
Antigua dhe Barbuda		25 Tetor 1988 s
Argjentinë		1 Qershor 1972 a
Armeni		18 Maj 1994 a
Australi		13 Dhjetor 1973 a
Austri		8 Shkurt 2008 a
Azerbaixhan		16 Gusht 1996 a
Barbados		6 Mars 1972 s
Belgjikë	28 Shtator 1954	27 Maj 1960 r
Belize		14 Shtator 2006 a
Benin		8 Dhjetor 2011 a
Bolivi		6 Tetor 1983 a
Bosnje dhe Hercegovinë		1 Shtator 1993 s
Botsvana		25 Shkurt 1969 s
Brazil	28 Shtator 1954	13 Gusht 1996 r
Bullgari		22 Mars 2012 a
Burkina Faso		1 Maj 2012 a
Çad		12 Gusht 1999 a
Kinë (në lidhje me Hong Kong)		
Kosta Rika	28 Shtator 1954	2 Nëntor 1977 r
Bregu i Fildishtë		3 Tetor 2013 a

* Pas rifillimit të ushtrimit të sovranitetit mbi Hong Kong-un, Kina njoftoi Sekretarin e Përgjithshëm se përgjegjësia për të drejtat dhe detyrimet ndërkombëtare të Hong Kong-ut në lidhje me Konventën do të merrej përsipër nga Qeveria e Republikës Popullore të Kinës.

Shtetet palë në Konventën e vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave pa Shtetësi (vazhdim)

Shteti	Nënshkrimi	Ratifikimi (r), Hyrja (a), Suksedimi / vijimësia (s)
Kroaci		12 Tetor 1992 s
Republika Çeke		19 Korrik 2004 a
Danimarkë	28 Shtator 1954	17 Janar 1956 r
Ekuador	28 Shtator 1954	2 Tetor 1970 r
Fixhi		12 Qershor 1972 s
Finlandë		10 Tetor 1968 a
Francë	12 Janar 1955	8 Mars 1960 r
Gjeorgji		23 Dhjetor 2011 a
Gjermani	28 Shtator 1954	26 Tetor 1976 r
Greqi		4 Nëntor 1975 a
Guatemalë	28 Shtator 1954	28 Nëntor 2000 r
Guine		21 Mars 1962 a
Honduras	28 Shtator 1954	1 Tetor 2012 r
Hungari		21 Nëntor 2001 a
Irlandë		17 Dhjetor 1962 a
Izrael	1 Tetor 1954	23 Dhjetor 1958 r
Itali	20 Tetor 1954	3 Dhjetor 1962 r
Kiribati		29 Nëntor 1983 s
Republika e Koresë		22 Gusht 1962 a
Letoni		5 Nëntor 1999 a
Lesoto		4 Nëntor 1974 s
Liberi		11 Shtator 1964 a
Libi		16 Maj 1989 a
Lihtenshtejn	28 Shtator 1954	25 Shtator 2009 r
Lituani		7 Shkurt 2000 a
Luksemburg	28 Tetor 1955	27 Qershor 1960 r
Maqedoni		18 Janar 1994 s
Malavi		7 Tetor 2009 a
Meksikë		7 Qershor 2000 a
Republika e Moldavisë		19 Prill 2012 a
Mal i Zi		23 tetor 2006 s
Hollandë	28 Shtator 1954	12 prill 1962 r
Nikaragua		15 korrik 2013 a
Nigeri		20 shtator 2011 a
Norvegji	28 Shtator 1954	19 nëntor 1956 r
Panama		2 qershor 2011 a

Shtetet palë në Konventën e vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave pa Shtetësi (vazhdim)

Shteti	Nënshkrimi	Ratifikimi (r), Hyrja (a), Suksedimi / vijimësia (s)
Peru		23 Janar 2014 a
Filipine	22 Qershor 1955	22 Shtator 2011 r
Portugali		1 Tetor 2012 a
Rumani		27 Janar 2006 a
Ruanda		4 Tetor 2006 a
Senegal		21 Shtator 2005 a
Serbi		12 Mars 2001 s
Slovaki		3 Prill 2000 a
Sloveni		6 Korrik 1992 s
Spanjë		12 Maj 1997 a
Shën Vincent dhe Grenadinë		27 Prill 1999 s
Svazilend		16 Nëntor 1999 a
Suedi	28 Shtator 1954	2 Prill 1965 r
Zvicër	28 Shtator 1954	3 Korrik 1972 r
Trinidad dhe Tobago		11 Prill 1966 s
Tunizi		29 Korrik 1969 a
Turkmensitan		7 Dhjetor 2011 a
Uganda		15 Prill 1965 a
Ukrainë		25 Mars 2013 a
Mbretëri e Bashkuar	28 Shtator 1954	16 Prill 1959 r
Uruguaj		2 Prill 2004 a
Zambia		1 Nëntor 1974 s
Zimbabve		1 Dhjetor 1998 s

Shtete që kanë nënshkruar por nuk kanë ratifikuar Konventën e vitit 1954 në lidhje me Statusin e Personave pa Shtetësi

Shteti	Nënshkrimi
Kolumbia	30 Dhjetor 1954
Salvadori	28 Shtator 1954
Selia e Shenjtë	28 Shtator 1954

Shtojca 2

Shtetet palë në Konventën e vitit 1961 për Reduktimin e Pashtetësisë

Data e hyrjes në fuqi: 13 dhjetor 1975

Numri i përgjithshëm i shteteve palë (në 1 maj 2014): 55

Vendi	Nënshkrimi	Ratifikimi (r), Hyrja (a), Suksedimi / vijimësia (s)
Shqipëria		09 Korrik 2003 a
Armeni		18 Maj 1994 a
Australi		13 Dhjetor 1973 a
Austri		22 Shtator 1972 a
Azerbaixhan		16 Gusht 1996 a
Benin		8 Dhjetor 2011 a
Bolivi		6 Tetor 1983 a
Bosnje dhe Hercegovinë		13 Dhjetor 1996 a
Brazil		25 Tetor 2007 a
Bullgari		22 Mars 2012 a
Kanada		17 Korrik 1978 a
Çad		12 Gusht 1999 a
Kosta Rika		2 Nëntor 1977 a
Bregu i Fildishtë		3 Tetor 2013 a
Kroaci		22 Shtator 2011 a
Republika Çeke		19 Dhjetor 2001 a
Danimarkë		11 Korrik 1977 a
Ekuador		24 Shtator 2012 a
Finlandë		7 Gusht 2008 a
Gjermani		31 Gusht 1977 a
Guatemalë		19 Korrik 2001 a
Honduras		18 Dhjetor 2012 a
Hungari		12 Maj 2009 a
Irlandë		18 Janar 1973 a
Xhamajka		09 Janar 2013 a
Kiribati		29 Nëntor 1983 s
Letonia		14 Prill 1992 a
Lesoto		24 Shtator 2004 a
Liberia		22 Shtator 2004 a
Libia		16 Maj 1989 a

Shtetet palë në Konventën e vitit 1961 për Reduktimin e Pashtetësisë (vazhdim)

Vendi	Nënshkrimi	Ratifikimi (r), Hyrja (a), Suksedimi / vijimësia (s)
Lihtenshtejn		25 Shtator 2009 a
Lituani		22 Korrik 2013 a
Republika e Moldavisë		19 Prill 2012 a
Mal i Zi		5 Dhjetor 2013 a
Hollandë	30 Gusht 1961	13 Maj 1985 r
Zelandë e Re		20 Shtator 2006 a
Nikaragua		29 Korrik 2013 a
Niger		17 Qershor 1985 a
Nigeri		20 Shtator 2011 a
Norvegji		11 Gusht 1971 a
Panama		2 Qershor 2011 a
Paraguaj		6 Qershor 2012 a
Portugali		1 Tetor 2012 a
Rumani		27 Janar 2006 a
Ruanda		4 Tetor 2006 a
Senegal		21 Shtator 2005 a
Serbi		7 Dhjetor 2011 a
Sllovaki		3 Prill 2000 a
Svazilend		16 Nëntor 1999 a
Suedi		16 Shkurt 1969 a
Tunizi		12 Maj 2000 a
Turkmensitan		29 Gusht 2012 a
Ukrainë		25 Mars 2013 a
Mbretëri e Bashkuar	30 Gusht 1961	29 Mars 1966 r
Uruguaj		21 Shtator 2001 a

Shtete që kanë nënshkruar por nuk kanë ratifikuar Konventën e vitit 1961 për Reduktimin e Pashtetësisë

Shteti	Nënshkrimi
Republika Domenikane	05 Dhjetor 1961
Francë	31 Maj 1962
Izrael	30 Gusht 1961

Shtojca 3

Instrument Model i Aderimit në Konventën në lidhje me Statusin e Personave Pa Shtetësi të 1954

NDËRSA Konventa në lidhje me Statusin e Personave Pa Shtetësi është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në ditën e njëzet e tetë të shtatorit,

një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër dhe është e hapur për aderim në pajtim me nenin 35 të saj;

DHE NDËRSA është paraparë në seksionin 3 të nenit 35 të sipërpërmendur që aderimi në të merr efekt me depozitimin i një instrumenti tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara;

TANI ME ANË TË KËSAJ nënshkruesi i mëposhtëm [Titulli i Kreut të Shtetit, Kreut të Qeverisë ose Ministri i Jashtëm] me sa më poshtë njofton aderimin e [Shtetit në fjalë]

DHËNË me dorën time në _____ këtë _____ ditë të _____ një mijë, nëntëqind e _____.

[Vula Publike dhe Nënshkrimi i
Kreut të Qeverisë, Ministrit të
Jashtëm]

[Nënshkrimi i Kreut të Shtetit
kujdestarit, nëse është e
përshtatshme]

Instrument Model i Aderimit në Konventën mbi Reduktimin e Pashtetësisë së 1961

NDËRSA Konventa mbi Reduktimin e Pashtetësisë është miratuar nga personat fuqiplotë Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në ditën e trembëdhjetë gushtit, njëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një dhe është e hapur për aderim në pajtim me nenin 16 të saj;

DHE NDËRSA është paraparë në seksionin 4 të nenit 16 të sipërpërmendur që aderimi në të merr efekt me depozitimin i një instrumenti tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara;

TANI ME ANË TË KËSAJ nënshkruesi i mëposhtëm [Titulli i Kreut të Shtetit, Kreut të Qeverisë ose Ministri i Jashtëm] me sa më poshtë njofton aderimin e [Shtetit në fjalë]

DHËNË me dorën time në _____ këtë _____ ditë të _____ një mijë, nëntëqind e _____.

[Vula Publike dhe Nënshkrimi i
Kreut të Qeverisë, Ministrin të
Jashtëm]

[Nënshkrimi i Kreut të Shtetit
kujdestarit, nëse është e
përshtatshme]

Shkurtimisht rreth IPU-së dhe UNHCR-së

IPU

Njësia Ndërkombëtare Paramentare–(NjNP)

IPU është organizata botërore e parlamenteve kombëtare. Ne punojmë për të ruajtur paqen dhe për të drejtuar ndryshimet pozitive demokratike përmes dialogut politik dhe veprimi konkret. Duke qenë organizata e vetme ndërkombëtare që sjell së bashku parlamentet kombëtare në të gjithë botën, ne promovojmë demokracinë dhe paqen nëpërmjet anëtarësisimit tonë unik parlamentar.

Puna jonë në forcimin e aftësive të parlamenteve për të përmbushur mandatin e tyre demokratik duke qenë më përfaqësues, transparent, të përgjegjshëm dhe efektiv mbështetet nga fokusi ynë mbi barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, zhvillimin dhe paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Ne shpesh punojmë me partnerët, përfshirë Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e saj të specializuara, për të siguruar që parlamentet kanë informacionin praktik më të përditësuar dhe të përshtatur për çështje që ata kanë për të trajtuar në nivel kombëtar.

Arritja e një grupi gjithnjë në ndryshim prej rreth 47,000 parlamentarësh në mbarë botën është kritike për çdo përpjekje për të informuar ndryshime në politikë dhe legjislacion. IPU është një, organ i pavarur vetëqeverisës i financuar kryesisht nga Anëtarët tanë. E themeluar në vitin 1889 dhe me 164 parlamente kombëtare si anëtarë dhe 10 trupa parlamentare rajonale si anëtarë të asociuar në vitin 2014, IPU është ende në rritje, duke reflektuar kërkesën botërore për demokraci.

UNHCR

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) është i mandatuar për të udhëhequr dhe koordinuar veprimtarinë ndërkombëtare për mbrojtjen e refugjatëve dhe zgjidhjen e problemeve të refugjatëve në botë. UNHCR lufton për të siguruar që kushdo mund të ushtrojë të drejtën të kërkojë azil dhe të gjejë strehim të sigurt në një shtet tjetër dhe të kthehet në shtëpi me vullnetin e tij. Duke i ndihmuar refugjatët për t'u kthyer në vendin e tyre ose të vendosen në një vend tjetër, UNHCR synon zgjidhje afatgjatë të situatës së tyre të vështirë.

Komiteti Ekzekutiv i UNHCR-së dhe Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara gjithashtu e kanë autorizuar organizatën të ndihmojë grupet e tjera të njerëzve, përfshi këtu edhe personat e shpërngulur brenda vendit.

UNHCR synon reduktimin e rasteve të shpërnguljeve me forcë duke i inkurajuar shtetet dhe institucionet për të krijuar kushte që janë të favorshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve.

Organizata ofron mbrojtje dhe ndihmë të refugjatët dhe të tjerët në një mënyrë të paanshme dhe mbi baza të nevojës së tyre pavarësisht nga raca, ngjyra, besimi fetar, opinioni politik apo gjinia e tyre. UNHCR është e përkushtuar ndaj parimit të pjesëmarrjes dhe i këshillon refugjatët për të gjitha vendimet që ndikojnë tek jetët e tyre. UNHCR punon në partneritet me qeveritë, organizatat rajonale dhe ndërkombëtare si dhe me organizatat joqeveritare

Publikuar nga Bashkimi Ndërparlamentar në bashkëpunim me Komisionerin e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të prodhohet, ruhet në një sistem të dhënash, apo të transmetohet në ndonjë formë ose mënyrë - elektronike, mekanike, me anë të makinës fotokopjuese, regjistruar, apo tjetër - pa lejen paraprake të Unionit Ndërparlamentar ose Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët.

Ky publikim shpërndahet në vartësi të kushtit që nuk është për tregti, apo në ndonjë mënyrë tjetër për t'u huazuar, shitur, dhënë me qira ose për t'u shpërndarë ndryshe pa lejen paraprake të botuesit, në çdo formë të lidhur apo me kopertinë, përveç me atë me të cilën është botuar dhepa ndonjë kusht të ngjashëm, përfshi vendosjen e këtij kushti mbi botuesin e radhës. Të gjithatë drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të prodhohet, ruhet në një sistem të dhënash, apo të transmetohet në ndonjë formë ose mënyrë - elektronike, mekanike, me anë të makinës fotokopjuese, regjistruar, apo tjetër - pa lejen paraprake të UnionitNdërparlamentar ose Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët.

Ky publikim shpërndahet në vartësi të kushtit që nuk është për tregti, apo në ndonjë mënyrë tjetër për t'u huazuar, shitur, dhënë me qira ose për t'u shpërndarë ndryshe pa lejen paraprake të botuesit, në çdo formë të lidhur apo me kopertinë, përveç me atë me të cilën është botuar dhepa ndonjë kusht të ngjashëm, përfshi vendosjen e këtij kushti mbi botuesin e radhës.

ISBN 078-92-9142-599-0 (IPU)




Foto në kopertinë:

Ratifikimi i kohëve të fundit nga ana e Bregut të Fildishtë të Konventave mbi pashtetësinë dhe reformat që ju bënë Ligjit Kombëtar, rezultuan në atë që mijëra persona pa shtetësi, përfshirë këtu edhe shumë fëmijë në këtë fshat, të kishin mundësi të marrin shtetësinë e Bregut të Fildishtë dhe përfitimet që ky status ju jepte.





Inter-Parliamentary Union

For democracy. For everyone.

 +41 22 919 41 50
 +41 22 919 41 60
 postbox@ipu.org

Chemin du Pommier 5
Case Postale 330
1218 Le Grand-Saconnex
Geneva – Switzerland
www.ipu.org



 +41 22 739 81 11
 +41 22 739 73 77

Case Postale 2500
CH-1211 Genève 2 Dépôt
Switzerland
www.unhcr.org